

ANTONIO CAIAZZA
NATA E TË MUNDURVE
ROMAN

BOTIMET TOENA

ANTONIO CAIAZZI

NATA E TË MUNDURVE

ROMAN

Përktheu nga italishtja: Diana Çuli

BOTIMET TOENA

Titulli në origjinal: La notte dei vinti
Botoi në origjinal: Nutrimenti, 2014

“Quest’opera è stata tradotta con il contributo del Centro per il libro e la lettura del Ministero della Cultura italiano.”

“Përkthimi i kësaj vepre është realizuar me kontributin e Qendrës për librin dhe leximin të Ministrisë së Kulturës italiane.”



Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi
Korrektore letrare: Sonila Kryeziu
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN:

© 2024 NUTRIMENTI srl
© 2025 BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. “M. Gjollësja”, nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

*Vitorios dhe Margaritës,
Babait dhe nënës*

E shkuara nuk ka vdekur; madje nuk është as e shkuar.

Krista Vulf (Christa Wolf)

HYRJE

Kushedi sa e madhe duhet të dukej Shqipëria në kohën e këtij rrëfimi, kur shqiptarët udhëtonin në këmbë, me biçikleta ose mbi karrocerinë e ndonjë kamioni dhe kur shumica e tyre nuk e kishin parë kurrë Tiranën, tepër e largët, si një mirazh. Ishte fat i madh të shkoje atje, qoftë edhe për t'u shtruar në spitalin qendror, ku të dërgonte mjeku i fshatit. Por, ndonëse shqiptarët nuk shkonin dot në Tiranë, ajo, Tirana, vinte tek ata, në një mënyrë ose në një tjetër. Në vitin 1975, në Shqipëri e kudo, gjithçka ishte kaq e palëvizshme dhe ajo botë dukej sikur do të mbetej e tillë, e përjetshme.

Dhe sa e largët ishte për ne, asokohe, Shqipëria. E panjohur, e kyçur në misterin e saj. E harruar, e anashkaluar. Asgjë tjetër, veç male në largësi, në anën tjetër të detit.

Në atë Shqipëri, në atë lloj brime të zezë, ndodhte historia që po rrëfejmë sot, dyzet vjet më vonë. Përtej dhe këndej detit ka ndryshuar gjithçka dhe, ky rrëfim, tani që distancat janë shkurtuar, është sadopak edhe historia jonë.

Ishte fundi i vitit 1975, kur në një fshat të vogël e të humbur u organizua një festë dhe rreth tridhjetë anëtarë të një kooperative bujqësore u dekoruan e u nderuan me çmime. Por, ishte një simulim. Ajo ceremoni i shërbeu Sigurimit të Shtetit për të zhvendosur vëmendjen e banorëve nga një operacion, që do të kryhej po atë natë.

Ishte akti i fundit i një "spastrimi", si quhej asokohe elimnimi i rivalëve dhe lufta për pushtet në partitë komuniste të Lindjes. Edhe për atë shqiptare (Partia e Punës, sipas emërimit zyrtar) ishte e njëjta gjë. Një vit më parë kishte ndodhur një tjetër, një vit më pas do të ndodhte përsëri. "Spastrimi" i kësaj historisë sonë goditi dhe i preu kryet ushtrisë. E gjithë klasa drejtuese u akuzua për tradhti dhe për grusht shteti. Në fund të 1975-s u pushkatuan komisar politik i ushtrisë (drejtues e mbrojtës ideologjik i aparatit ushtarak), kreu i Shtabit të Përgjithshëm dhe ministri i Mbrojtjes, të tre gjeneralë.

Ngjarja që do të tregojmë këtu lidhet me figurën e këtij të fundit. Ajo është ndërtuar dhe bazuar në procesverbalet e inkuizicionit politik që

NATA E TË MUNDURVE

ushtronin organet e Partisë, të dokumenteve të çmuara e të ruajtura në Arkivin Kombëtar të Tiranës e të pasqyruara këtu besnikërisht, ndonëse me pjesë të shkëputura, dëshmi mizore të halucinacioneve që mund të godasin pushtetin. Jo vetëm atë komunist dhe jo vetëm në atë periudhë.

1

Shqipëri, lugina e lumit Shushicë, 21 gusht, 2010. E shtunë.

Taksia e verdhë e Qemalit, që shkëlqen e tëra, ngre pas pluhurin e rrugës së paasfaltuar dhe përshkon luginën e ngushtë e të gjatë. Nga njëra anë e saj gurë të stërmëdhenj, të rrokullisur nga mali dhe nga ana tjetër shkëmbinj të thepisur.

Qemali rri ulur në sediljen e pasme. Ka ngarë makinën nga Tirana deri në hyrje të luginës. Por, disa kilometra pasi kalojmë Vlorën, përpara se të hyjmë në pjesën më të vështirë të udhëtimit tonë, ia lë timonin Çetit, të birit. Djaloshi flet një italishte të kuptueshme.

- Përse po shkojmë në Vranisht? - pyet befaz Çeti, në njërën nga kthesat e shumta.

Përtypem pak.

- Për një varr, - përgjigjem dhe kthehem e vështroj.

Ai më shikon, unë buzëqesh, por i flas me seriozitet.

- Për një varr në Vranisht? - i thotë pastaj të atit, në shqip, duke e parë ngultas nëpërmjet pasqyrës që ka përballë.

Herë pas here lugina zgjerohet, ndehet me fusha me mullarë të rrumbullt kashte dhe me lëndina të gjelbra, të ndara në mes nga lumi i shkumëzuar me guralecë të bardhë. Përtej, përvijohen majat dhe faqet e çrregullta të maleve tepër të larta, mbuluar me pyje ose tërësisht të zhveshura.

Në ndenjësën e pasme, Qemali, që i ka mbushur gjashtëdhjetë e tre dhe e ka jetuar atë kohë tashmë të varrosur, vështtron nga dritarja. Taksia kalon përmes fshatit Kotë, në të djathtë e në të majtë të rrugës shihen ndërtesa të ulëta, të kaltëryera, të kooperativës bujqësore të dikurshme. Duhet të kenë qenë stallat. Pak më tej, në dy ndërtesa po të ulëta, ngjyrë të verdhë të zbërdhulur, janë apartamentet e fshatarëve, ish-kooperativistë, ndërtime krejt të njëllorja me ato të qyteteve, përfshirë dhe kryeqytetin, të ndërtuara për kooperativistët dhe punonjësit e tjerë.

Sot, përpara hyrjeve të kabanoneve të vjetra të stallave dhe të vathëve të bagëtisë shihen gra me funde të gjata dhe me shami mbi flokë, që shesin bluza si njolla ngjyrash, radhë-radhë buzë rrugës, në kuti të mëdha kartoni.

Qemali vështron përjashta, por, pa e kuptuar, mendja i fluturon diku tjetër. I kujtohet rinia. Ishte minator. Sapo kishte kryer dy vjet ushtri. Si të gjithë, thuajse si të gjithë në Tiranë, kishte vetëm një biçikletë. Dhe me atë shëtiste gruan dhe shkonte në punë në tunelet e qymyrit, nja dhjetë kilometra lart qytetit, natën dhe ditën, sipas turneve të caktuara nga shokët e drejtorisë. Patentën e mori shumë vjet më vonë, kur miniera u plaçkit e u braktis, kur biçikleta, tanimë e vjetër dhe e ndryshkur nuk i hynte më në punë, kur shokët që gërmonin bashkë me të nën tokë, fqinjët e shtëpisë, shokët e vjetër të shkollës, ushtarët e skuadrës së tij të kohës së ushtrisë, miqtë të kafeneja, një pjesë e mirë e të panjohurve që haste mëngjeseve u shpërndanë nëpër botë dhe kur rrugët u pushtuan nga mijëra makina. Kryesisht “Mercedesë”. Si taksia e tij e verdhë, që ia sollën nga Gjermania pesëmbëdhjetë vjet më parë.

Por, ajo taksi dukej fringo e re, as edhe një gërvishtje, e shndritshme, e pastër, erëmirë me *Arbre Magique*, varur te pasqyrëza. “Ku i solla deri këtu...”, mendova, duke vështruar rrugën e prishur, ndërkohë që hekurat gërvijnë nga kthesat dhe marmita fshiket herë pas here pas gurëve. Njerëzit të klubit e fshatrave na ngulin sytë me habi, me gotën ngritur pezull, tek çajmë mes pluhurit.

- Oh... po, po, - thotë Qemali, duke tundur kokën sa majtas e djathtas. - Edhe ne në minierë e morëm vesh. Tridhjetë e pesë vjet më parë. Edhe ata, shokët minatorë, një ditë u mblodhën në sallën e drejtorisë dhe atje, para të gjithëve, sekretari i organizatës bazë na lexoi njoftimin e Komitetit Qendror.

Në një heshtje varri, flegrat e Qemalit thithën erën e vdekjes, thuajse ajo duhmë e neveritshme hyri së bashku me mizat nga dritaret e mëdha, të lëna hapur për shkak të vapës së gushtit. Ishte djersë dhe frikë. Ishte era e tmerrit, që dilte nga poret e trupave të mbledhur në atë sallë. Pasi e dëgjuan, duartrokitën. Duartrokitje ritmike, duartrokisnin e ngriheshin të gjithë njëherazi, pastaj zërat e kryetarëve të ekipeve, që hidhnin parullën “Parti-Enver, Parti-Enver...” dhe përsëri vrunduj duartrokitjesh, në fillim të çrregullta e më pas, ngadalë, të disiplinuar,

përsëri të drejtuara si një sërë rrjedhash e përrunjsh drejt një lumi të vetëm, në një rrahje të vetme duarsh, që jehonte në sallë dhe përjashta dritareve dhe përhapej në sheshin e zbrazët të mbuluar me pluhur.

Ishte një ditë e përvëlur, nuk luante gjethja. Ajri i ngrirë, i palëvizshëm, si flamujt e kuq të varur kokëposhtë, të palosur në mijëra pala. Përmes dritareve dalloheshin dhe atë ditë ngjanin të trishtuar, flamujt të kuq majë kullës së transportuesit përmbi grykën e pusit, përmbi zyrat e vogla të drejtorisë dhe të fjetoreve, përpara mensës. Ndërkohë ata bërtisnin me të madhe: “Lavdi Partisë, lavdi Partisë...”, përpara shokut sekretar, të gjithë me grushtin tek tëmthi, të gjithë nën vështirimin e Enverit dhe të Mehmetit nga fotografitë. Vetëm fryma e zërave të tyre të ngjirur, vetëm pëllëmbët e duarve të tyre të dërmuara lëviznin në ajër. Në atë kohë Qemali nuk i kishte mbushur ende të tridhjetat.

Imazhet e atij të riu me thonjtë e nxirë nga qymyri, vegimet e flamujve të kuq dhe gërvimat e biçikletës i zhduken nga sytë dhe përpara dritares së taksisë risheh fytyrën e tij të rrudhur e të djegur nga dielli e, nga ana tjetër, shitëset e bluzave me ngjyra te pragjet e stallave të vjetra.

- Gjeneralët puçistë..., - thotë, pa ia ndarë sytë peizazhit, teksa “Mercedesi” vazhdon rrugën.

2

Tiranë, 19 qershor, 1974. E mërkurë.

Ministri dëgjoi të shoqen të kthehej dhe të shtynte jorganin nga shpina. Me dritën e paktë që depërtonte nga grilat ndjeu se u ul mbi shtrat, duke kërkuar pantoflat me këmbë. Kur ajo lëvizi, dysheku u ngrit paksa.

- Sonte nuk ke mbyllur sy, - i tha, tek hapi pak dritaren. Në dhomë hyri një fllad ajri i freskët. Pastaj tërhoqi rripin e perdes dhe nga tri të çara vertikale kaloi drita, i preku profilin, përshkoi një tufë flokësh dhe ra mbi komonë prej mogani ngjyrëkafe. Ajo u kthye dhe e vështroi.

- Çfarë ke? Si është puna?

Ministri kaloi dorën mbi flokë, mbylli sytë fort dhe pastaj i hapi. U gëlltit, uli kryet, ndërsa dorën e mbante pas qafës, si të ngrirë. Lëvizi kokën majtas e djathtas dhe ndjeu se nuk po e mbanin më nervat. E shoqja, përballë dritës, përpara dritares, nuk ia ndante sytë.

- Mendimet e përhershme, të njëjtat probleme...

- Nuk je njësoj, ka ditë që të shoh shumë të shqetësuar. Çfarë po ndodh?

Ministri u kthye në ije dhe u ngrit, duke u mbështetur mbi bërryl. Nxori krahun tjetër nga poshtë jorganit me çarçafin me dantella të bardha dhe e ngriti lart përgjysmë, drejt së shoqes. Ajo iu afrua. Ngriti pak rrobëdhomën prej leshi të butë bojë qielli, vendosi njërin gju mbi shtrat dhe u përkul mbi të shoqin, duke u mbështetur te krahu i tij. Ia futi fytyrën në gropën e qafës, i ndjeu djersën dhe i erdhi ndër mend ngrohtësia mikpritëse, e sigurt e agimeve të një jete të tërë.

- Vetëm një herë të kam parë kështu, - tha, ngriti kokën dhe e vështroi drejt në sy. -Kur i bënë gjyqin Tukut të shkretë. Po tani, kush e ka radhën? Një tjetër mik i yti, apo jo?

Nuk priti përgjigje. Anash qepallave gjysmë të mbyllura të ministrit rrodhën dy pika të rënda loti. Shtrëngoi krahun më fort rreth saj. Gruaja

afroi faqen tek ajo e burrit dhe e puthi. Dhe në atë çast vuri re mbi komodinë kopertinën e lëkurtë të një libri, që i ngjau menjëherë i afërt e i largët, “Udhëtimet e Guliverit”. Në përgjumjen e shqetësuar të asaj nate e kishte dëgjuar të ngrihej e të dilte nga dhoma, por donte të besonte se ai shkoi në bibliotekën e studios ta kërkonte për fëmijët atë libër të vjetër.

- Bëj gati makinën. Do të zbres për pesë minuta.

Porta e vogël e vilës u hap dhe pas saj doli koka e ministrit dhe dora e tij e hapur, për të treguar numrin pesë. Shoferi vuri re jakën e bardhë të këmishës, nyjën ende të çlirët të kravatës së zezë dhe nuk i shpëtuan nga vëmendja flokët e shpupuritur dhe fytyra e lodhur, e plakur papritmas. Rediani ndezi motorin, e la makinën në afolio dhe doli të hapte derën e hekurt në fund të rruginës. Sapo të dyja kanatet u hapën tej e tej, u ndez motori edhe i një veture tjetër: u shqua xhami dhe pjesa e saj e përparme e hirtë te qoshja përballë rrugës, dy blloqe më tutje.

“Zili” i zi i ministrit doli nga shtegu, mori majtas dhe, në kryqëzim, u kthye përsëri majtas. Rrugët e “Qytetit të ndaluar” hijezoheshin nga gjethnaja vidhash dhe lisash. Rreth pesëdhjetë metra më tej, ndoshta më pak, makina doli në rrugën e madhe buzë lumit të Lanës. Prej andej, ja dhe Tirana: biçikleta, karroca, autobusë me rimorkio, të bardhë e të kuq, njerëz që ecin më këmbë. Makina ngjyrë gri e Sigurimit e parakaloi qoshen pas së cilës kishte qëndruar fshehur, u kthye djathtas dhe përshkoi të njëjtin itinerar. Qëndronte në largësi, por Rediani nuk e shqiste nga sytë, duke e vëzhguar te pasqyrëza.

- Ku do të shkojmë? - pyeti, kur ishin në kryqëzim, duke kthyer kokën pas, mes sediljeve.

- Në Dajt, - u përgjigj ministri.

- Te hoteli? - pyeti i habitur Rediani.

- Në mal, - saktësoi tjetri, duke vështruar në bosh.

- Shoku Ministër, nëse shkojmë te zona speciale, më mirë të marrim fuoristradën, - ngulmoi Rediani, që ngurronte të vazhdonte rrugën.

- Jo, do të shkojmë te *Belvedere*-ja.

Shoferi futi marshin e parë dhe makina mori djathtas ngadalë.

Ministri e përdorte rrallë makinën. Rediani më tepër e ndiqte më këmbë, në një distancë të respektueshme. I shërbente si shofer vetëm

kur shkonte të inspektonte reparte, baza ushtarake, baza në ndërtim e sipër, kur merrte pjesë në manovra e kur nganjëherë dilte jashtë Tirane. Por, në ministri, në Kryeministri, në Komitet Qendror ose në sallën e hotel “Dajtit” shoku ministër shkonte gjithnjë më këmbë, edhe kur qyteti shndërrohej në baltë e llucë ose mbulohej nga një çarçaf i butë e i ngrirë dëbore. Ministri, i gjatë e i bëshëm, kështu ruante formën dhe ishte i vetmi zakon i mbetur nga jeta ushtarake. Në dimër Rediani mbërthehej në kapotën e tij ushtarake dhe i rrinte pas, duke u ngrohur me një cigare te buzët. I kishte zili kolegët e tij, që i shpinin ngado shefat e tyre të ulur këndshëm tek timoni, pa u lagur, pa rrezikuar të ftoheshin. Për fat, rruga ishte e shkurtër, disa kilometra së shumti, por në stinën e ftohtë të gjithë të tjerët nuk hiqnin dorë nga ngrohtësia e makinës së Shtetit. Ishte po ajo rrugë gjithnjë, në fakt, e njëjta për të gjithë. Makinat e shefave të Partisë dhe të ministrave dilnin nga zona private e pushtetit, ku banonin dhe niseshin drejt ndërtesave të pushtetit publik, zyrave të Partisë, dikastereve, Presidiumit, Këshillit të Ministrave, shkonin lart e poshtë gjithnjë nëpërmjet të njëjtit itinerar, disa kilometra dhe, për ndokënd, vetëm pak qindra metra.

Me ardhjen e pranverës shumë makina qëndronin në garazh ose në oborrin e vilave. Të parat ato të drejtuesve më të rinj e me shëndet më të mirë. Të shkoje në zyrë më këmbë i bënte të ndiheshin komunistë më të vërtetë. Dhe kështu, në trotuarin e gjerë të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” shoku anëtar i Byrosë Politike ose shoku ministër, ecte drejt përpara me buzën në gaz, i sigurt, me kokën lart, dikush me elegancë, dikush tjetër me mburrje. Në njërën dorë një çantë pune prej lëkure të zezë mbushur me dokumente, disa hapa pas truproja. Rrallëherë shoku drejtues ecte me dikë pranë. E rrethonte një hapësirë boshe, si një fluskë e padukshme dhe e papërshkueshme. Pothuajse e papërshkueshme. Të vetmit vërtet të aftë ta shponin fluskën e pushtetit ishin të vjetërit, kryesisht ish-partizanët, që ndiheshin autorët dhe pronarët e kësaj Shqipërie, ndonëse kurrkush nuk i merrte parasysht. Kur njihnin një shok drejtues, edhe pse ndodhej në anën tjetër të rrugës, e kapërcenin atë, buzëqeshnin me të madhe me gojën me dhëmbë të rënë dhe ecnin drejt tij me grushtin në anë të ballit dhe krahun e nderur, për t’i shtrënguar dorën të fuqishmit. “Si je, shoku Ramiz?”, “Si je, shoku Mehmet?” “Oh, shumë mirë, shok, faleminderit!”, përgjigjej tjetri dhe vazhdonte

drejt rrugën për në zyrë. Ndërsa të rinjtë nuk e kishin këtë shkujdesje. Nuk kishin arsye. Atë pushtet e kishin gjetur aty: nuk kishin luftuar për ta vendosur, nuk merrnin pjesë në asnjë lloj mënyre për ta mbajtur. Ai ishte dhe kaq qe e gjitha. Për ta, ata ishin të pushtetshmit. Për ta, ata komandonin. Ndihehin të ndruajtur dhe ndërronin rrugë kur i shihnin të kalonin. Ulin kokën pa fjalë, duke vështuar tërthorazi, e vazhdonin në punë të tyre.

Ministri i Mbrotjes Popullore, pra, ishte më ngulmuesi për të ecur më këmbë. Dhe, kur të vinte dita e gjyqit, edhe për këtë do ta akuzonin. “Qëndron pak me shokët e partisë. Je gjithnjë rrugëve, shëtitjeve. Do të dukesh, të biesh në sy. Je populist dhe demagog, aspak një komunist”, do t’i ulërinin në fytyrë.

Vetura mori majtas dhe hyri në bulevard, mes një turme njerëzish me biçikleta. Ata që i ngisnin, sapo dëgjonin zhurmën e motorit të afrohej, kthenin pak kokën dhe pastaj e shmangnin menjëherë biçikletën në njërën anë, që t’i hapnin rrugë makinës. Në atë qytet pa makina nuk ishte nevoja t’i bije burisë.

Dielli nuk ishte ngritur ende mirë në lindje dhe hidhte një dritë të ngrohtë mbi qytet. Rrezet hynin paprerë mes ndërtesave dhe drurëve anës rrugës. Pastaj, sytë e ministrit u përmytën nga një dritë e fortë kur hynë në sheshin “Skënderbej”. Një ekip punonjësish të ministrive dhe të Komitetit Ekzekutiv, rreshtuar në pesë radhë përpara një instruktori, me këmbët hapur dhe krahët nderë, po bënë gjimnastikë, duke kthyer trupin ngadalë, në mënyrën orientale. Makina kaloi anash Pallatit të Kulturës dhe u fut në Rrugën e Dibrës, në drejtim të malit të Dajtit. Asfalti sa vinte e bëhej më i ngushtë, derisa u ndërpre dhe makina eci përmbi gurë të bardhë. Qindra gra, me funde të zeza, të gjera e të gjata deri në fund të këmbëve po zbrisnin në qytet me kanistra kashte mbi krye, plot me perime për në pazar, një treg i vogël privat, ndaj të cilit pushteti komunist e mbyllte një sy. Punëtorë e punonjës shkonin e vinin me biçikleta ose më këmbë dhe, dikush që do t’i vëzhgonte do të vinte re se sa përshëndetje, sa shtrëngime duash, sa tundje koke, sa ftesa për të pirë diku një kafe shkëmbenin me njëri-tjetrin. Në kohën e kësaj historisë sonë, kryeqyteti i Shqipërisë banohej nga pak më shumë se njëqind mijë njerëz dhe ishte një qytet, ku të gjithë njiheshin ose kishin lidhje me njëri-tjetrin, në një rrjet të pambarimtë dhe të ndërthurur marrëdhëniesh.

Sytë e ministrit vështronin gjithçka dhe asgjë, ndërkohë që makina vazhdonte rrugën me tundje e shkundje, duke ngritur pas re pluhuri. Kaloi përpara fabrikës së Porcelanit dhe përshkoi lagjen “Varri i Bamit”, gjithë ndërtesa të ngritura rishtazi, në të cilat askush nuk dëshironte të banonte, sepse, siç thuhej, ndillte keq dhe natën endeshin lugetërit shpirtligj, që nuk gjenin prehje. Pikërisht aty, komunizmi prej disa kohësh e kishte prishur varrezën për të ndërtuar banesa për punëtorët e fabrikave të reja. Asaj fushe të shenjtë i kishte mbetur vetëm emri dhe rrëfenjat e vjetra, që akoma i shkaktinin shumë telashe zyrës komunale të shpërndarjes. “Te “Varri i Bamit”? Te “Varri i Bamit”, shok, atje dashke të na dërgosh?” “Pse, çfarë nuk të pëlqyeka ty nga shtëpitë e ndërtuara nga Partia?”, pyeste atëherë, i acaruar dhe i ndërkryer, punonjësi i asaj zyre. “Jo, jo, asgjë, eh, e ku kemi pasur shtëpi në një pallat, më përpara? Ne vijmë nga fshati... Por, e kuptoni dhe vetë, shok, thonë se aty poshtë ka kocka...” Shpesh, nëpunësi i zyrës përgjigjej, herë të tjera nuk e merrte mundimin. “Injorantë... ja se kë na sjellin në Tiranë”, mendonte dhe mbushte formularin e dorëzimit të apartamentit, e kalonte poshtë xhamit të sportelit: ““*Varri i Bamit*”, *pallati nr...*” dhe u tregonte numrin e pallatit, në një lagje ende me rrugë të pashtuara e të paemra.

Ministri i dinte mirë këto histori. Ai ishte tiranasi i vetëm në Byronë Politike. Të tjerët kishin ardhur në qytet në krye të formacioneve partizane dhe aty kishin qëndruar, kishin hequr uniformat, kishin dorëzuar armët dhe ishin shndërruar në klasën e re drejtuese. Disa prej tyre shkelën për herë të parë në qytet pikërisht në atë ditë fund-nëntori të vitit 1944, kur, pasi dëbuan gjermanët, marshuan fitimtarë gjatë gjithë bulevardit.

Ministri ia njihte shpirtin atij qyteti, mallin, këngët, vallet, aromat, i njihte mbiemrat e mijëra familjeve deri në shumë breza të mëparshëm, lidhjet fafëfisnore dhe martesore, shtëpitë e mëdha e mbiemrat brez pas brezi. Ai e kuptonte humorin e Tiranës, e parandiente gëzimin e trishtimin, dinte ta kuptonte kur ishte e shkujdesur, shpërfillëse ose e zyrtë, pikaste dëshirën për festime apo akullnajën e frikës. Ishte në simbiozë me të. Ndjenjat e qytetit ishin njëherazi dhe të tija. I këndej të bënte piknik në lëndinat rreth qytetit çdo Një Maj, nuk e humbiste kurrë atë festë me dhjetëra mijëra tiranas, për asgjë në botë, edhe sikur vetë

Enveri ta ftonte në vilën e tij. Dhe, kur grumbujt e njerëzve e dallonin, ai nuk priste, por ngrihej e hidhej në valle duke qeshur, të gjithë në rreth, me Redianin dhe shumë të tjerë të njohur, të gjithë me gotën e vogël të rakisë në dorë. Në pushimin e parë të orkestrës, të gjithë do t'i uleshin pranë për t'i thënë se një xhaxha, një vëlla, një vjehërr, një kushëri i tretë ose një koleg e njihnin ose njihnin një dajën e tij, ose se kishin shërbyer në ushtri, kur ai ishte aty drejtues. Ministri e dinte se Tirana ishte e uritur, kur kamioni i qumështit nuk mbërrinte, kur furnizimi me mish mungonte prej një periudhe të gjatë. Shtëpia e tij ishte në cep të “Qytetit të ndaluar”. Dera e madhe e hyrjes dilte në rrugën e fundit të brendshme në lagjen e nomenklaturës; por më pas, një deriçkë shërbimi hapej ndaj një tjetër qyteti, ndaj atij të të gjithëve. Aty Rediani e dinte se duhet ta priste në mbrëmje, pas darke, për shëtitjen e fundit të ditës, përgjatë Lanës.

Historitë e besëtytnive të “Varrit të Bamit” ministri i kishte marrë me mend që ditën kur, në mbledhjen e Këshillit, ministri i Ndërtimit paraqiti planin urbanistik të kryeqytetit. E shpalosi hartën e madhe mbi tryezë dhe kolegët u ngritën ta këqyrnin. Një vijë e hequr me laps të kuq ngrihej, përthyhej, shkonte drejt një qosheje e më pas bashkohej me zonën e qytetit ekzistues, duke përvijuar lagjet e reja dhe zgjerimin e madh në verilindje të tij. Ministrat u entuziazmuan. “Më në fund, një kryeqytet i vërtetë”, menduan. Ministri qeshi me vete, duke përfytyruar lodhjen e pafundme për të zhvendosur qindra familje nga fshatrat përreth në atë kuadrat të kuq. Zërat mbi eshtrat e varrosura poshtë rrugëve dhe pallateve do të përhapeshin menjëherë, gojë më gojë mes të porsaardhurve dhe do t'i tmerronin. Burrat do të heshtnin, duke mbytur në tym të paprerë duhani atë vendosje të mallkuar dhe në ndeshje të pambarimta shahu. Por, kush mund t'i ndalte ankimet e grave të tyre? *Të vdekurit nuk lëndohen... dhe nuk ka paqe për atë që nuk i lë në prehje kockat...* Duhet t'u shpjegosh se këto janë besëtytni... se materializmi na mëson... *Por ato, në kasollet e tyre, në shitore, në sheshpushimet e shkallëve, përpara dymësive të mëdha, gjithnjë do të flasin për të njëjtën gjë. Mjafton t'i shohësh për së largu për t'i kuptuar; mjafton të vësh duart e tyre të shqetësuara që tregojnë dheun atje tej, madje nëndheun...*

Dhe ndodhi pikërisht kështu. Por, Tirana u mësua shpejt edhe me këtë, nuk kaloi shumë kohë e nuk ua vuri më veshin qarjeve të atyre grave analfabete, që zbrisnin në qytet të shisnin perime të mbjella e të rritura në lehet e “Varrit të Bamit”.

Ja ku janë, gjithnjë veshur me të zeza, gjithnjë njëzet vjet më të vjetra sesa mosha e tyre e vërtetë, por të forta, madje të paepura, prashitëse dhe të papunuar kurrë, ja ku qëndrojnë nga ana tjetër e dritares së vogël, me kokën e palëvizshme nën kanistrën e baraspeshuar, me një krah mbështetur në ije dhe me vështrimin ngulur përpara drejt Pazarit të Ri.

“Zili” doli nga ajo lagje, kaloi murin e lartë të pasmë të Kinostudios, por ai nuk e vuri re, ashtu si nuk vuri re as se si filluan të marrin maloren drejt majës së malit. Mendja i fluturonte tjetërkund. Një ditë më parë, në hapjen e sesionit të Kuvendit Popullor iu vërtetua frika së cilës i druhej: shokët e Byrosë Politike, edhe ata më në zë të Komitetit Qendror e trajtuan si të marrë fund, asnjeri prej drejtuesve nuk iu afrua, përkundrazi, iu shmangën. Vetëm pak deputetë, që ishin nga fshatrat, e përshëndetën si përherë, me ngrohtësi e respekt. Por, në divanin e vogël të sallorit të ngushtë dhe në tavolinat e barit, gjatë pushimeve, ai mbeti vetëm: deputetët e panjohur të zonave më të largëta nuk u ulën me të nga përkujdesja; ata më të shquarit nuk iu afruan, sepse e dinin më së miri ose pjesërisht se çfarë do të ndodhte; udhëheqësit më të lartë tanimë e quanin një të huaj. Ishte vetëm. Për këtë u bind që atë ditë.

Askush nuk ka shpëtuar dot. Askush nuk ia ka dalë dot mbanë. As nuk janë përpjekur. As Tuku, as Temja, askush tjetër... askush. Por, përse? Shpesh njeriu nuk arrin ta përfytyrojë përse e sheh të pamundur dhe atëherë nuk luan as gishtin... gjëja bëhet e pamundur, sepse ai nuk lëviz, vetëm për këtë. Madje bëhet e pamundur, sepse nuk e mendon, por, ndoshta, po ta mendonte ose, nëse përpiqej, do të zbulonte se është e mundur. Se mund të bëhej.

Nëse nuk bëj asgjë, nëse pres, do ta paguajnë edhe ata... do ta pësojnë edhe vajzat e vogla.

Si kështu? E kush? Ne të dy, me katër fëmijë, me një dhëndër, një nuse e dy mbesa. Edhe Rediani, edhe ai, me gruan dhe fëmijën e vogël... menjëherë. Më duhen të paktën dy furgonë dhe nuk kam një

shofer të besuar. Edhe një pilot. Nëse mund ta gjej. Nëse më vjen pas akoma. Mjafton ta shoh në sy për të kuptuar se do pranojë ose jo. Por, trembëdhjetë veta jemi shumë. Por, kush, atëherë? Si t'ia bëj ta zgjedh? Dhe me siguri, jemi nën kontroll, që tani.

Dreq! Jam ministri i Mbrojtjes, jam akoma ministri i Mbrojtjes dhe nuk mundem t'i shpëtoj me një avion, të paktën vetëm ata?

Të paktën ata, nga zjarri që po na përpin. T'i shpëtoj nga shkatërrimi.

Sepse kështu do të përfundojë. Ashtu si ka përfunduar gjithmonë. Në fillim do të më kërkojnë të pranoj gabimet, pastaj të punoj me ndërgjegjen time, për të kuptuar përse i kam bërë dhe për të pastruar vetveten. Dhe, kur të pranoj se kam gabuar, do të më përjashtojnë.

Apo do të më nxjerrin në pension? Po sikur Enveri të vendosë të më lërë në pension? Ai e di si ka lindur kjo historia e mallkuar e tezave, se ai vetë më shtyu t'i bëja. Edhe të gjithë shokët e dinë këtë. Ai e njej dëshirën time për të dalë në pension, se nuk ia kam kërkuar vetëm një herë... Në pension dhe në kufi, në Tepelenë, në Pukë, në Përmet...në Çermenikë, në Miçan, ku të dojë ai, ka plot vende ku të më varrosë të gjallë e të më harrojë përgjithmonë. Për çfarë i duhem i vdekur?

Dhe pastaj, për këtë histori sa më pak të flitet, aq më mirë është... Jemi të vegjël, por për një ministër të Mbrojtjes të pushkatuar do të flasë e gjithë bota, edhe pse është shqiptar. Pas disa muajsh lajmi do t'i kapërcejë kufijtë. E si mund t'i shpëtojë Beogradit pa e marrë vesh! Për Shqipërinë do të jetë një dëm. Enveri e di. Do të bënte figurë të keqe. Kur pushkatohet një ministër, do të thotë se ka qenë i rrezikshëm për të, pra se regjimi nuk është kompakt, paska të çara, kërcënime të brendshme. Kur ministri i pushkatuar është ministër i Mbrojtjes, jashtë shtetit do të fillojnë të flasin për përpjekje për ta rrëzuar, fraksione, luftëra të brendshme, ndarje, rivalitete. Partia e ndarë. Si t'ym në sy, për Enverin. Do të numërojmë ditët e fundit në një fshat të humbur, të shënuar vetëm në hartat ushtarake, ku askush nuk e di ku bie dhe ata që na njohin nuk do të na gjejnë kurrë e, në fakt, askush nuk do të na kërkojë. Fëmijët... ata do të hiqen nga puna, nuk do të bëjnë më karrierë, por nuk do të përndiqen, nuk do të kenë as miq, as armiq. Do të harrohen, edhe ata, dhe kështu do të jetë më mirë. Në djall universiteti, diplomat, studimet jashtë. Punëtorë të thjeshtë, gjithë jetën. Udhërrëfyes, rojë fabrike, portierë shkolle, nuk ka rëndësi.

...por, po më vrau? Djemtë do të përfundojnë në minierë, në punë të detyruar. Dhe ajo, e vetme, ose me ndonjërin prej tyre, në një fshat... baltë... të ftohtë... këpucë të vjetra, këpucë burrash, të miat, të rrëmbyera në ngut e sipër dhe të hedhura në thes përpara se të futen në furgon, të mbathura në këmbë çdo ditë, këpucë më të mëdha sesa numri i saj, tre centimetra boshllëk pas thembrave.

Çfarë i vjen më mbarë atij? Ka dhjetë vjet që nuk ka pushkatuar më njeri. I fundit ishte Temja... në vitin 196... pra trembëdhjetë vjet. Ishte djalë i ri, por më i miri që kishim. "Shoku Enver, i propozoj Këshillit të Mbrojtjes emrin e shokut oficer Teme Sejko për gradën e admiralit dhe të komandantit të flotës sonë ushtarake..." Dhe kështu e dënova me vdekje. E admiroja, e dija se ai kishte qenë nderi i Akademisë në Volgograd dhe pastaj mjaft më me brezin e ish-partizanëve dhe me karrierat e tyre për merita antifashiste. I vumë të komandonin njësinë e "Mig"-ëve dhe të brigadave të raketave, sepse kishin drejtuar brigadat partizane në luginat e tyre. Po, në fillim i dërguam në disa shkolla lufte në Hungari ose në Bashkimin Sovjetik, por disa prej tyre edhe mezi dinin shkrim e këndim. E vërtetë se ata ishin djemtë më heroikë të popullit, më besnikët. Enveri i donte. Dhe të tjerë, në thelb, nuk kishte. Ndërsa Temja ishte krenaria jonë. Kur erdhi momenti ia hapa rrugën... dhe kur erdhi momenti tjetër nuk luajta as gishtin për ta shpëtuar. Çfarë mund të bëja? Enveri nuk kishte më besim tek ai. E kishin njoftuar për miqësinë e tij me komandantin sovjetik në Pasha Liman, për apartamentet njëri sipër tjetrit, për takimet e grave të tyre, për kafetë që pinin... Sigurimi ia kishte përgatitur planin. E transferuan në ministri, në një zyrë mbi katin tim. Dhe, ditën kur e arrestuan, më thanë ta thërrisja. Ia vunë prangat para syve të mi. Temja ishte tridhjetë e nëntë vjeç. Shpresa, e shoqja, asokohe ishte tridhjetë e dy. Takoheshim së bashku, kur Temja u kthye nga Rusia. Fëmijët, Raimondi dhe Sokoli ishin... trembëdhjetë dhe njëmbëdhjetë vjeç, më duket. Sytë e tij tek të mitë, përsipër të mive, në mbledhjen e Komitetit Qendror, gjatë procesit. Të mitë, ulur poshtë, mbi fletët, mbi shkarravinat e zeza, që bëja me stilograf. "Votojmë për përjashtimin e shokut Teme Sejko nga Komiteti Qendror dhe nga Partia. Kush është pro?" Lashë stilografin dhe ngrita dorën. Dhe kur ngrita edhe sytë, i gjeta të tijtë gjithnjë mbi të mitë. Por, tanimë të vdekur.

Ka trembëdhjetë vjet që nuk pushkaton më njeri. Partia do

të terrorizohet përsëri, ai do t'ua bëjë të qartë të gjithëve se kush komandon këtu dhe kush është më i fortë. Reagimet e jashtme... do të jenë minimale, praktikisht asnjë. Po do të ngjallen iluzionet në ambasadat këtu në Tiranë, në Ministritë e Jashtme, diplomatët do të përpilojnë dy-tri faqe raport e gjithçka do të marrë fund. Dy-tri ditë e më pas heshtje. Beogradi do të zhurmojë nga një javë, por pastaj edhe atje do të pushojnë. Në vendet e tjera do të flitet për një regjim gjakatar, të tmerrshëm, për të do të thonë se është një diktator mizor, i gatshëm të zhdukë të gjithë bashkëpunëtorët e tij më të afërt, të gjithë ish-drejtesit e Luftës Çlirimtare do të shkohen në plumb me akuza absurde, megjithëse ata kanë treguar përherë besnikëri e bindje. Do ta përcaktojnë të pamëshirshëm, të egër. Dhe çfarë të reje ka këtu? Këtë gjë për të, jashtë, ka vite që e thonë. Pasoja më e gjatë do të jetë në Parti: mornica të ftohta do t'u kalojnë të gjithëve nëpër trup, një frikë e pastër, dyshimi në çdo veprim: e bëra mirë apo keq? Gjithnjë dilema të përjetshme se si mund të interpretohet çdo vendim, sado i parëndësishëm qoftë. Paraliza. Gjithçka duhet të kalojë nëpërmjet tij. Ku do të ndërtohen lagjet e reja, në cilin drejtim duhet të zgjerohet Tirana apo Korça, ku të shpohet për të gjetur naftë, ku të mbillen agrumet apo mollët e në cilën faqe kodre, ta shtrojmë me asfalt apo ta lëmë të pashtruar shtegun e mushkave, po kooperativën e... e Divjakës ta orientojmë drejt rritjes së pulave apo janë më mirë patat? Gjithçka duhet të kalojë përmes tryezës së tij të punës. Dhe ai, i mbushur me veten, triumfator, thotë: "Po pse, unë do të merrem me të gjitha? Po ju, çfarë bëni?" Dhe ata do të tmerrohen si të bien në një pus të zi. Cili vendim do të ishte aq i parëndësishëm, sa të mos i raportojë atij? Dhe kur duhet më mirë ta lënë atë të vendosë diçka, t'i kërkojnë një këshillë... një mësim tuajin tejet të çmuar, shoku Enver. Kur? Ku ndodhet ai kufi? "Por, përse nuk erdhe tek unë ose te shokët e Byrosë Politike? Përse nuk i ke treguar dyshimet e tua? Mes shokëve kështu veprohet, mes komunistëve të vërtetë..." Ai do t'i mbajë fort në grushtin e tij. Si na ka pasur gjithmonë, nëse është fjala për këtë. Dhe, në qoftë se më pushkaton, do t'ua kujtojë edhe një herë. Në dukje asgjë nuk do të ndryshojë. Do të ketë të njëjtin respekt, të njëjtin nënshtrim. Të njëjtin adhurim. Në Parti, përveç frikës, asgjë nuk do të ndryshojë. Por, në kokën e tij, po. Një ekzekutim është dëshmi e pushtetit, të krijon siguri. Ka parë intrigat, konspiracionet, përpjekjet për puçe,

ngritje kryet, tradhtitë, lojërat e dyfishta dhe të trefishta, kthimin e fletës, hakmarrjet, atentatet, vrasësit e paguar, ka parë zilitë të bashkohen dhe të organizohen, pra Shqipërinë e viteve njëzet dhe atë të Mbretit Zog, Shqipërinë e rreckosur, pa dinjitet e pa respekt, Shqipërinë e spiunëve dhe të keqbërësve, të ministrave rrogëtarë të italianëve, të jugosllavëve, grekëve, francezëve, austriakëve, që ishin mjeshtër të ekuilibrave dhe të dinakërive, të aftë të luanin në shumë tavolina dhe t'iu shërbenin shumë ambasadave. Një herë në javë shkonin nëpër legata, uleshin në tryezë me konsujt dhe nën pjtatën e vogël të çokollatave gjenin zarfin. Brenda tij, lireta, shilinga, dinarë ose franga dhe bursa studimi jashtë shtetit për bijtë. Ambasadori në një ambasadë, sekretari, këshilltari në një tjetër ose në dy të tjera. Shqipëria e sëmurë, e shitur, e ngrënë nga minjtë. Ai e di se e gjithë kjo mund të rikthehet. Derisa ka ndodhur, mund të ndodhë përsëri. Ai e njeh kompleksin tonë të inferioritetit ndaj të huajve. Nuk është vetëm mikpritje, është admirim, shpesh i tepruar, për të huajt. Ndoshta është vetëm vetëdijshmëri për kufizimet tona, e mundësive tona, të cilat kurrë nuk kanë qenë të shumta. Por, kur ua kemi hapur dyert, ata edhe na kanë blerë. Dhe ne u jemi shitur. Jemi ndarë dhe jemi shitur. Për ato zarfet nën pjtazë, për një rrotullim valse në legatë, për një udhëtim jashtë shtetit, për një bursë stud...

Ministri u luhat, shpina iu shkëput nga shpinorja e ndenjësës ku ishte mbështetur. U përkul përpara. Makina kishte ndaluar. Dhe mes sediljeve të parme u shfaq treçereku i fytyrës së Redianit. Përtej xhameve të dritareve dukej qielli i kaltër përmbi majat e Dajtit dhe pyllit të pamatë, maja të panumërta, gryka, lugina dhe përrenj prej aty e deri në Burgas, në Detin e Zi.

- Shoku Ministër...

- Ndalo përpara kafenesë.

Makina lëvizi përsëri dhe parkoi ngadalë përpara hyrjes së lokalit, një ndërtesë me tulla të kuqe, me derë të rëndë prej druri.

- T'ju pres këtu?

- Po.

Mbi sheshin e vogël binte drita e fortë e diellit. Kur ministri shtyu derën iu duk sikur hyri në errësirë. Në të djathtë, një banak i gjatë, në fund të të cilit ishte makina e kafesë ekspres dhe në faqen e murit një raft me tri radhë katesh me pesë shishe gjithsej, dy me raki, dy me verë

të kuqe dhe një me verë të bardhë. Në të djathtë të sallës disa tryeza të vogla.

Vështroi përreth, nuk kishte njeri. Përpara tij drita e kaltër e tarracës. Eci në atë drejtim, te një tryezë prej hekuri të rrahur pranë parmakut të hekurt. E la kapelën mbi tryezë dhe u mbështet tek ai parmak të kundronte pamjen.

Poshtë shtrihej qyteti i tij, në një fushë të gjelbër, vende-vende anës me liqene artificiale. Drejt veriut dukej njolla e asfaltuar e aeroportit. Në largësi ndehej deti. Dhe, nga ana tjetër e atij deti...

...tetëdhjetë kilometra, njësoj sa këtu e deri në Vlorë. Por, si të arrijmë deri atje? Vështroi horizontin me sytë e rrudhur, duke kafshuar buzën e poshtme. Qëndroi ashtu një copë herë, i ngulur përpara parmakut, me vështimin drejt diçkaje të padukshme. Duke menduar se si. Duke risjellë ndër mend gjithë sa kishte menduar paprerë gjatë gjithë asaj nate, duke rikthyer në mendje po ato dyshime, duke përllogaritur po ato mundësi dhe duke mbetur gjithnjë pa përgjigje. Një det përpara. Por, një gjë e kishte të sigurt dhe mendimet i niseshin përsëri nga ajo pikë.

...Nuk do të shpëtojmë. Asnjë autokritikë, asnjë pranim faji nuk do të më shpëtojë mua dhe familjen. Fadilin dhe Todin i kanë degdisur në punë të detyruar, gratë në internim, fëmijët në burg. Dhe ata ishin njëri ministër i Kulturës e tjetri drejtor i Radiotelevizionit. Ministri i Mbrojtjes... ministri i Mbrojtjes nuk mund të trajtohet në të njëjtën mënyrë. Çfarë mesazhi do t'u jepte të tjerëve? Se të gabosh në mbrojtjen e vendit është si të gabosh në përzgjedhjen e këngëve në një festival? Të vendosësh ku t'i caktosh repartet dhe armatimet e rënda qenka e njëjta gjë me rishikimin e akordeve muzikore? Do të më ekzekutojë. Duhet ta bëjë. Si mund të veprojë ndryshe? Shqipërinë e ka shndërruar në fortesë, në kazermë, çdo civil është një ushtarak... një popull i tërë nën armë... i stërvitim edhe fëmijët si të qëllojnë me armë, jemi të rrethuar nga armiqtë. Atje, në fund është NATO-ja, nga pas është Jugosllavia, blloku sovjetik... kinezët, shpejt do të përfundojmë e do t'i dëbojmë edhe ata... inxhinierët tanë më të mirë punojnë në industrinë e armëve, investojmë në ushtri njëzet e tre për qind të buxhetit, bëjmë përpjekje të çmendura për të blerë jashtë shtetit teknologji ushtarake, marrim teknikët më të mirë për ta kopjuar dhe për ta riprodhuar... dhe pastaj i

shpëton jetën ministrit të Mbrojtjes pasi e ka akuzuar për paaftësi? Por, ai do të shkojë edhe më tej, do të më akuzojë për tradhti, e sigurt... Si ndodhi me Temen, ka për të thënë se kam qenë në shërbim të NATOS-s, të kinezëve, të rusëve, të Titos, edhe të të gjithëve së bashku, do të thotë se kisha në mendje një puç... Tani Petriti më akuzon, mendon të shpëtojë në këtë mënyrë, duke ma hedhur mua të gjithë fajin. Ndoshta mendon të bëhet ministër në vendin tim... i gori... Ne do të paguajmë të tre, unë, Petriti edhe Hitoja. Dhe, meqenëse kemi ushtrinë në dorë, jo një festival këngësh, ai do të na zhdukë të treve... Asnjëri prej nesh nuk e ka vënë kurrë në rrezik Shqipërinë, as nuk është shitur apo të ketë menduar ta përmbysë atë vetë, ai e di mirë, por ka nevojë ta bëjë këtë proces për t'i mbajtur nën fre njerëzit tani që nuk do të ketë më ndihma nga jashtë dhe askush nuk do të ngarkojë më anijet me grurë për të na i dërguar, kur të mbjellat tona nuk do të mjaftojnë... Thotë se do të hamë bar dhe do të ndodhë pikërisht kështu, por për këtë i duhet të tregojë dhëmbët, duhet t'u kujtojë të gjithëve se nuk bëhet shaka me të, që askurrkujt mos t'i shkojë në mendje ta vërë në diskutim.

Për herë të parë, qëkur kemi vendosur pushtetin popullor, jemi vetëm. Vetëm, kundër të gjithë botës. Dhe nuk jemi as RDGJ-ja, as Rumania... Edhe Çaushesku ka një bazë më solide për t'ia dalë mbanë, për të rezistuar pa as edhe një aleat, ka industri, ka universitete, ka lëndë të para, ka tridhjetë milionë rumunë... Ndërsa ne? Ne do të hamë bar! Po, pikërisht kështu do të ndodhë, Ramizi, Kadriu, Hysniu e dinë... Mehmeti e di... Mehmeti... Atij, më së shumti Enveri dëshiron t'i kujtojë se kush komandon, se sa e tmerrshme mund të jetë t'ia dredhësh... Tani Mehmeti po përgatit letrat të më nxjerrë jashtë loje, i jep shpresa Petritit se do të më zërë vendin e kështu të ma ngrejë kundër... Por, Mehmeti duhet të ketë mendjen e të mos e ngrejë shumë kokën, ndryshe të shtënat e tjera të plumbave mund të jenë për të. Ka nisur të shkruajë dhe libra e të udhëtojë i vetëm nëpër Shqipëri, të takojë popullin... në vend të qëndrojë një hap pas Enverit. Është shumë i sigurt, i duket vetja gjykatës si Enveri, në një nivel me të. Dhe nuk e kupton se Enveri, duke më vënë mua pas murit, i dërgon një mesazh edhe atij... Hysniu është i plakur dhe i sëmurë, kështu, udhëheqësi i ardhshëm, kur të vijë ai moment, kur Enveri të ikë nga kjo botë, do të jetë ai, Mehmeti. Ai është i pari që e di. Hysniu hyn e del në Klinikën Speciale, Enveri në tetor

pësoi infarkt... dhe ai tani fryn gjoksin dhe bredh krenar lart e poshtë. Ka vënë dhe t'i kompozojnë këngë në emrin e tij. Por, Enveri, duke më pushkatuar, i dërgon lajmin të rrijë urtë, aty ku i takon, të ulë kokën, të vihet në resht e të ketë durim. Me plumbin tim po i tërheq veshin atij dhe po u tregon dhëmbët dhe të gjithë të tjerëve, si përherë. Dhe, nëse nuk e kupton, tjetri ka për të qenë ai vetë... Dhe Mehmeti, me aq sa e njoh... nuk do ta kuptojë...

U shkëput nga parmaku, uli kokën dhe u shkoi dorën flokëve. U kthye dhe u ul tek tryeza. Kërkoj me sy kamerierin dhe, brenda, në gjysmëhije, shqoi Redianin. I bëri shenjë me dorë t'i vinte pranë. Erdhi edhe kamerieri.

- Çfarë dëshironi?
- Një kafe ekspres, shok. Faleminderit, - u përgjigj shoferi.
- Një kafe ekspres dhe një ujë.

Kamerieri u largua me të shpejtë dhe në tryezë ra heshtja. Ministri vështroi përsëri horizontin, ndërsa Rediani e vëzhgonte pa rënë në sy. I vuri re qeskat e fryra poshtë syve. Ballin me tri rrudha të thella si brazda. Ndjeu heshtjen, tepër e pazakontë. Kur e kishte parë kaq të ngrysur? Sa shumë kishte ndryshuar këtë muajin e fundit, qëkurse kishte filluar të pikaste në pasqyrëzën e vogël atë "Ladën" ngjyrë gri, që nuk u shqitej! Rediani e kuptonte se tanimë po shëtiste me makinë një njeri të vdekur. E dinte si shkonin këto punë. Shofer ishte, por në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe njihte shumë njerëz. Dhe, në heshtjet e gjata, mes një udhëtimi e një tjetri, atje, në dhomën e shoferëve, ku pinin cigare e luanin me letra, kishte dëgjuar shumë histori të tilla. Edhe ministri e kuptonte fare mirë se ishte i marrë fund dhe, duke e njohur mirë, e dinte se në heshtjen e tij kishte vetëm shqetësim për familjen. Ministri i tij tashmë gjendej në fije të perit, i shkelur me këmbë, gjë që e kishte nuhatur prej javësh, por, atë ditë, në kafenenë në faqen e malit të Dajtit, tek priste te banaku shefin e përkulur mbi parmak, nuk pati më asnjë dyshim.

Iu afrua një burrë. I pëshpëriti diçka në vesh, kërkoj raki dhe, ndërkohë që kamerieri u largua për të marrë shishen te rafti, u kthye nga Rediani dhe e pyeti, pa e vështuar:

- Ku do ta shpiesh tani?

Dhe shoferi, i shtangur, me gjakun që i ngriu në damarë, tundi vetëm kokën dhe belbëzoi:

- Nuk ma ka thënë akoma.

Tjetri nxori nga xhepi një copë letër e një laps dhe i vendosi mbi banak. Dhe, gjithnjë pa e vështuar, shtoi:

- Ma shkruaj këtu se ku do ta çosh.

Pastaj doli nga kafeneja.

Dhe Rediani, kur ministri e piu dhe gllënjkën e fundit të ujit tonik, e pyeti, jo vetëm për të thyer heshtjen:

- Ku do të shkojmë tani, shoku Ministër?

- Në Rinas, - iu përgjigj ai.

- Po niseni gjekund, shoku Ministër?

Ministri u gëlltit dhe ndoshta u zbeh nga ajo pyetje. Ngriti sytë dhe e vështroi i trembur Redianin, thuajse tjetri ia kishte lexuar mendimet dhe turbullimet. Për fat të mirë, nuk u përgjigj menjëherë, ndryshe do të kishte bërbelitur vetëm fjalë pa kuptim.

- Do bëj një inspektim te repartet e fluturimit, një vizitë... vetëm një vizitë.

U ngrit dhe iu afrua banakut, i ndjekur pas nga Rediani, la aty një bankënotë dhe banakieri, që e njohu, e përshëndeti me qëndrim gatitu, me grushtin tek tëmthi. Ai shkoi drejt makinës, shoferi e parakaloi për t'i hapur derën, pastaj, ndërsa po e mbyllte, i tha:

- Shoku Ministër, pesë minuta, sa të shkoj në banjë e nisemi.

Rediani u fut vërtet në banjë, por, kur mbaroi, përpara se të dilte nga salla e kafenesë u afrua te banaku dhe shkroi atë që duhej mbi copën e letrës ende aty. Iu duk vetja tradhtar. Por, mendoj edhe se këto ishin gjëra që nuk kishin lidhje me të. Urdhri ishte urdhër. Edhe ai ishte punonjës i Ministrisë së Brendshme, si ata të “Ladës” ngjyrë gri. Dhe kishte grua e fëmijë.

Doli nga salla, nxitoi drejt makinës e ndezi dhe u nisën. E mori gjerë kthesën te sheshi dhe u fut në rrugën nga erdhën, po tani në zbritje. Në ato pak pjesë të drejta, mes një kthese e një tjetre, Rediani kontrollonte rrugën pas përmes pasqyrës, por makina e Sigurimit nuk dukej më.

U desh gjysmë ore të ktheheshin në Tiranë, të përshkonin edhe një herë sheshin “Skënderbej”, të hynin djathtas në rrugën e spitalit dhe në fund, përpara stacionit, të ktheheshin majtas. Makina kaloi përpara

Arkivit Kombëtar, Institutit Fullc dhe doli përsëri jashtë qytetit. Ishte rruga për në Durrës, por, pas doganës së vjetër, në kryqëzimin për në Vlorë, mori djathtas, drejt aeroportit.

Ajo rrugë kishte mbetur e njëjtë, e ngushtë, e asfaltuar që në kohën e italianëve. Në vitin 1959, disa muaj përpara ardhjes së Hrushovit, në Byronë Politike u diskutua nëse mund të zgjerohej, “sepse lidh kryeqytetin me një aeroport ndërkombëtar, në fund të fundit”, kishte guxuar e folur para mendjes një shok. Asgjë nuk u bë. Enveri i dëgjonte opinionet e ndryshme me ballin mbështetur te gishtat e dorës së djathtë dhe rrallë ngrinte shikimin nga tavolina. Dhe, në hamendjen se çfarë mendimi apo opinionit kishte ai vetë, shokët njëri pas tjetrit nisin të shpreheshin njëkohësisht kundër e pro. Andej nga fundi, diskutimet, gjithnjë e më ngurruese përballë fytyrës së ngërthyer të Enverit dhe syve të tij të ulur, u kufizuan vetëm në përshkrimin e problematikave dhe anëve pozitive të asaj vepre. Dhe, pastaj diskutimet u shuan.

Kështu, rruga mbeti ajo e para dhe “Zilit” të Ministrit atë ditë iu desh të ndalej e të vendoste shenjat ndaluese, që të kalonin dy kamionë ushtarakë. Ministri pothuajse nuk i vuri re. Pas retinës së syve të tij lëvrinin imazhe që nuk shihte, shkrepeshin *flash*-e dritash e hijesh, të qarta e të errëta, ngjyra pa kuptim: e bardha e vijave të gëlqeres, me të cilën lyhej trangu i plepave, e gjelbra e livadheve, kafja e errët e fushave të mbjella, bojëqielli i murit të ndërmarrjes, e kafja e çelët e shtyllës elektrike, njollat shumëngjyrëshe të shpinave të grave të kërrusura tek prashisin tokën... Nën mbulesën e errët të njërit prej dy kamionëve po ikte një pjesë e fatit të tij të mundshëm: njëra prej dy rrugëve po mbyllej, njeri dyshim i tij po zgjidhej vetvetiu.

...edhe sikur të mos më vrasë... kush më siguron se do të më nxjerrë në pension dhe se pjesën e mbetur të jetës do ta kaloj me time shoqe? Fshati i harruar, ku do të kaloj ditët e fundit, në mjerim, por në paqe, mund të jetë vetëm një mirazh. Tuku nuk pati mundësinë të jetonte ditët me Mitën e tij. As me fëmijët, që ishin katër dhe të vegjël, kur e arrestuan. Çdo muaj i shkruante një letër Mitës dhe çdo muaj merrte një prej saj. Mita u kishte rrëfyer fëmijëve se babai ishte larg me shërbim dhe do të kthehej shpejt. Kush më ka treguar për këto letra? Nuk më kujtohet më. Ai pyeste për fëmijët, më shumë për Bujanën, për më të voglën... asokohe do të ketë qenë katër a pesë vjeçe. Mita punonte edhe jashtë

orarit, për t'i shpënë ushqim dhe mbulesa në burg. Në fund Tuku u sëmur dhe vdiq në qeli, në Kaninë. I shkreti Tuk... Të gjithë e dinin se ishim shumë miq...

Makina ngadalësoi ecjen dhe pastaj ndaloi.

Ministri pa t'u afrohej figura e ylbertë e një ushtari.

Rediani uli xhamin e dritares, zgjati kokën dhe tha:

- Shoku Ministër i Mbrojtjes.

Roja u afrua edhe pak, hodhi një sy brenda dhe mori menjëherë qëndrim gatitu me grushtin rrëzë ballit. Pastaj rendi të ngrinte trarin. Dhe makina hyri. Kaloi pas ndërtesës së fluturimeve civile, ku parakaloi kullën e vogël të kontrollit dhe mbërriti te një ndërtesë tjetër, e ulët, e fshehur mes pemëve. Një ushtar ulur te shkallaret e kazermës u ngrit, mori pushkën e mbështetur pas murit dhe e hodhi në sup. Ministri hapi derën sapo vetura ndaloi dhe zbriti përpara Redianit. Ngjiti shkallët i ndjekur me sy nga ushtari.

Ky i fundit, i hutuar, pa ditur si të vepronte, shikoi pyetës shoferin.

- Ministri, - iu përgjigj Rediani. Dhe ushtari u ngurtësua i tëri.

Ministri përshkoi korridorin e shkurtër dhe hyri në dhomën e parë të vogël, në të majtë. Aty ishin tri tavolina, me karriget lënë në mënyrë të çrregullt pranë. Mbi njërin prej tyre, mbështetur pas murit, ishte një telefon, në një tjetër një tufë letrash dhe në të tretën një fushë shahu me gurët lënë në gjysmë të lojës. Bishta cigaresh nëpër tavllat. Ministri doli dhe hyri te dhoma ngjitur, te zyra e komandantit. Bosh. E zbrazët edhe salla e madhe në fund, me raftet personale dhe ndonjë kaskë fluturimi, lënë aty.

- Ku janë pilotët? - e pyeti ai ushtarin.

- Janë larguar, - u përgjigj tjetri.

- Ata të skuadriljes gjuajtëse?

- Po, - u përgjigj i ndrojtur ushtari.

- Po ata të transportit?

- Edhe ata, shoku Ministër.

- Po komandanti?

- Të gjithë. U larguan gjysmë ore më parë, me kamionët. Me uniformë e pa uniformë, por të gjithë u larguan.

- E kuptova. - U kthye, përshkoi përsëri korridorin dhe doli në oborr. Ndaloi aty për një çast, pastaj eci përgjatë rruginës perimetrike,

së cilës i binte hija e aheve dhe ndahej nga rruga përjashta me një rrjetë. Pesëqind metra më tej ishte hangari më i madh i aeroportit. Ata më të vegjlit, të gjelbër e në formë koni, gjysmë nën tokë, ata të gjuajtësve, ishin të shpërndarë në fushën përpara pistës. Dera e kabanonit të madh ishte e hapur përgjysmë. Ministri kapërceu pragun dhe qëndroi të shihte. Ja ku ishin, të shndritshëm, me pengesa druri përpara dhe pas secilës rrotë. I pari kishte mbërritur në një ditë pranvere të vitit 1957. Nga Tirana erdhën ta prisnin gjeneralët dhe ndonjë ministër. Ishte edhe ai, me uniformë dhe me çizme. Edhe atë ditë, qielli ishte në ngjyrë të kaltër të thellë. Dhe, në një moment diçka vezulloi në mes të tij dhe një zhurmë e shurdhër sa vinte e dëgjohej më shumë. Aeroplani kreu një rrotullim të gjerë, pastaj u largua drejt veriut, u rrotullua përsëri dhe filloi të ulej, paralel me asfaltin. Ngriti një re pluhuri dhe parakaloi me shpejtësi përpara delegacionit që po e priste. Mbërriti në fund të pistës, u harkua djathtas, u përkul dhe u kthye mbrapsht, shumë ngadalë, me motorët zhurmues, derisa u ndal përpara ndërtesës së aeroportit. Kur rrotat ndaluan dhe, edhe helika e fundit pushoi së rrotulluari, kushedi pse, shqiptarët duartrokitën me hare. Në thjeshtësinë e tij ai ishte vetëm një aeroplan, si mund ta përfytyronte edhe një fëmijë, i përkryer për të qenë lodër dhe vërtet, ky IL-14-a ngjante si prej kallaji. “Më në fund, për të shkuar në Moskë nuk do të kemi më nevojë që rusët të na dërgojnë avionët e tyre nga Bullgaria”, mendoi ministri dhe kështu menduan të gjithë e ndoshta prandaj dhe duartrokitën.

Në hangar ndodheshin tre avionë “Iljushin”, krejt njësoj me njëri-tjetrin. Dhe një heshtje e madhe. Edhe mekanikët, elektrikistët, punëtorët manovalë i kishin larguar. Edhe Bardhylin.

Bardhyli kishte marrë patentën në Kinë, në shkollën e fluturimeve ajrore në Guilin dhe kur në vitin 1973 nga Pekini erdhi Antonovi për të marrë delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes e për ta çuar në Lindje, në kabinë, pas pilotëve kinezë, ishte edhe ai. Vizita zgjati një muaj dhe Bardhyli bënte pjesë në grupin përfaqësues shqiptar, që shkonte për vizitë në njësitë ushtarake, bazat ajrore dhe fabrikat e armëve. Ishte edhe Partizani i plotë, skuadra e futbollit e ushtrisë. Këtu ministri pati rastin dhe e njohu Bardhylin. U bënë miq, edhe pse piloti ishte rreth tridhjetë vjet më i ri. Gjatë rrugës shumë të gjatë të kthimit kinezët ia besuan atij komandën si pilot i dytë dhe ministri, krenar, shkoi në kabinë ta shikonte. Në Tiranë vazhduan të takoheshin shpesh.

Me Bardhylin mund të fliste dhe ndoshta ai do të pranonte ta merrte përsipër çmendurinë e tij. Ishte djalë i vetëm dhe nuk kishte as grua, as fëmijë. Vetëm dy prindër, shumë të moshuar, në Berat. Komanda e kishte caktuar në transport. Një herë kishte ardhur ta shihte ministrin, thjesht sepse ndodhej në ndërtesë për një praktikë dhe kaloi ta takonte.

- “Iljushinët” janë avionë të mrekullueshëm, sigurisht, nuk janë më të rinj, por me kolegët kinezë do të mundim t’i mirëmbajmë. Ata ngrihen, zbresin dhe rrotullohen në një shami, shoku Ministër, - i tha, - por ne i ngremë, i zbresim dhe i rrotullojmë vërtet shumë pak. Kemi nëntë dhe nuk dimë çfarë të bëjmë me ta, si t’i përdorim. Kjo është e vërteta. Mëkat, - dhe qeshi me të madhe. - I shikoj si rrinë aty pa lëvizur dhe më vjen keq. - Ministri e vështroi, piloti e vështroi gjithashtu dhe, pa hapur gojë, ata i thanë gjithçka njëri-tjetrit. Ministri hapi krahët dhe u lëshua në një karrige, pas skrivanisë. Nxori një shishe të vogël rakie dhe dy gota nga një sirtar dhe ndërruan bisedë.

Do ta kishte marrë Bardhylin përkrahu, do të largoheshin pak nga pista dhe ai do t’i fliste, ndoshta me pëshpërimë, me gjysma fjalësh e frazash, duke u ndalur e duke e vështruar, me shpresë se do të kuptonte pa pasur nevojë që ai t’ia thoshte të gjitha. Me shpresë se do ta kuptonte që ministri nuk komandonte më dhe i kishte ditët e numëruara, se po ia shtrëngonin çarkun çdo çast e më tepër. Si do t’ia kishte thënë? Me një frymë, menjëherë, pa u menduar? Apo nuk do të dilte nevoja, se ai do ta kuptonte vetë? Por, në një moment do t’i duhej t’i thoshte: “Kam menduar të...” A duhet t’ia thoshte atë fjalë, apo edhe jo? Atë herën që ishin parë sy më sy ishin kuptuar e ndoshta, edhe këtu në aeroport, piloti do të dinte përsëri të lexonte sytë e ministrit. Po të mundej, do të shihte në ta fjalën “arratisje.”

Por, Bardhyllit nuk do t’i duhej të lexonte asgjë dhe ministri nuk kishte pse lodhej t’ia linte të kuptonte. Të gjithë repartin e fluturimeve ajrore e kishin larguar prej aty.

Ministri u kthye, doli nga hangari dhe eci me ngut drejt makinës. Rediani nxitoi e u ul te vendi i tij, e vështroi përmes pasqyrës e ai shqiptoi vetëm një fjalë:

- Në shtëpi.

Gjysmë ore më pas “Zili” qëndroi përpara vilës. Rediani zbriti të hapte derën e hekurt dhe ta fuste makinën në oborr, por edhe ministri doli nga makina dhe e ndaloi.

- Shpjere makinën në garazhin e ministrisë dhe lëre atje. Edhe ti, nga nesër nuk ka nevojë të vish më këtu. - Pa e vështruar, e mbylli vetë derën e makinës, përshkoi rruginën dhe hyri në shtëpi.

Trageti “Greqia” drejt Durrësit, 14 gusht 2010. E shtunë mbrëma.

Anija doli nga Porto Vekio i Triestes në orar. Është gjashtë e mbrëmjes. Mbi det rëndojnë retë, në qytet fryn era e ftohtë dhe e thatë e verilindjes dhe mbi urë bien pika shiu e hidhen dallgët. Jemi në mes të gushtit, por bën ftohtë. Perëndimi i diellit ka një dritë të çuditshme, të filtruar nga re të largëta dhe nga shira të padukshme tej në det. Gjiri është një pellg i madh i gjelbër dhe i rrudhur: në fund një vijë e kaltër dhe horizonti një vijë e zezë. Këto ngjyra ngjallin pasiguri, e dobësojnë sigurinë për t’u nisur, për të shkuar diku, të lënë vetëm, pa mbështetje, pa qartësi, të zbrazin përbrenda. Është vetëm parmaku, ku mund të mbahemi, me kornizën prej druri dhe që lëkundet nga dridhjet e motorit.

Anija ecën drejt horizontit. E kuqja verbuese duhet të jetë burgosur pas atyre avujve të errët. Do të mjaftonte një gradë më shumë për ta çliruar. Një nisje e tillë nuk të lehtëson, nuk ndjell gjë të mirë. Ndiej ankthin që lind kur je në vendin e gabuar, por nuk e di as se cili mund të jetë ai i duhuri. Njësoj sikur ky udhëtim të jetë një gabim. Nuk jam i qetë. Përse po e bëj? A ka kuptim? Ndërkohë që vrundujt e erës më ngjeshin xhupin pas trupit, më duket sikur do të jem varmihës i një race të zhdukur. Do të kthehem përsëri në atë arkiv dhe do të kërkoj edhe një herë të shoh proces-verbalet e gjyqeve dhe të ekzekutimeve, të betejave të kota për t’u mbijetuar akuzave absurde, në një lojë makabre ku viktimat e di që do të vdesë, xhelatët, ish-miq të tij, e kanë dënuar tashmë, por i kërkojnë të mbrohet, të paktën të shpjegojë përse... *“sepse ka shumë rëndësi të kuptojmë gabimet tona dhe t’i tregojmë Partisë se vërtet duam të ndryshojmë”*, dhe ai ua plotëson dëshirën, mbrohet, i pranon fajet, kërkon falje dhe këtë e bën për të luajtur rolin, *“ishte një mendjelehtësi nga ana ime, u tregova i përciptë, u mashtrova nga disa prirje mikroborgjeze që kishin qëndruar si mbeturina në personalitetin tim dhe do t’i korrigjoj, do të punoj me veten”*, por ai e di se do të vdesë.

Përsëri këtë po kërkoj. Po përpiqem të kuptoj përse burra të fortë, të një brezi të hekurt, luhateshin si lavjerrës në pritje të plumbit kokës pa kundërshtuar kurrë dhe, për të njëjtin plumb, të shihnin shokët në sy e të thoshin: “Por, kjo nuk është luftë klasash. Kjo është vrasje.”

“Përse mendova ta shpërndaja ushtrinë në male? Përse, Enver? Nuk e di përse e përpunova këtë strategji të re mbrojtjeje? Nuk e di përse dhjetëra ushtarakë kanë punuar ditë e natë për të shkruar tezat tona të reja të mbrojtjes? Oh, sigurisht që ti e di! Sepse ishte ti, tre vjet më parë që na the të riktheheshim te lufta partizane. Mua më dukej idiotësi e tmerrshme t’u kërkonim kinezëve avionë luftarakë supersonikë, raketahedhëse, qindra tanke dhe pastaj t’i riktheheshim luftës partizane. Por, ti kështu doje, sepse kështu kishin vepruar edhe shokët vietnamezë dhe atje dërgove Vaskë Gjinyin, për të studiuar metodat e tyre të luftës. Dhe ne hartuam tezat e reja. Ndërrova mendje, Enver? T’i hedhim në kosh, të ndezim një zjarr të madh në oborrin e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. T’i zhdukim, t’i harrojmë. Letër ishte, lojëra ushtarësh. Por, mos e quaj luftë klasash këtë. Klasat i kemi luftuar së bashku, tridhjetë vjet më parë. Unë dhe ti, Enver, ti dhe Mehmeti, ti dhe Hysniu, ti dhe Ramizi, Abdyli, Adili, të gjithë këtu brenda i përkasim së njëjtës klasë. Madje, së njëjtës racë. Kush prej jush ka dalë ndonjëherë nga shtëpia nga dera e pasme? E? Po ta kishit bërë, sot do ta dinit se ne jemi një racë e ndryshme nga ajo e shqiptarëve të tjerë.”

Por, Ministri i Mbrojtjes Popullore nuk shqiptoi kurrë asnjë nga këto fjalë. Pamja e tij e fundit është një fotografi, në të cilën vështron gjykatësit e Gjykatës së Lartë, teksa i japin vendimin. Është nëntor i vitit 1975, ka veshur një pallto të trashë, trupin paksa të përkulur, i dobët dhe me duart përpara, të bashkuara. I dëgjon me vëmendje dhe me shumë seriozitet.

Tiranë, 18 gusht 2010. E mërkurë.

Kam takim me Shkrimtarin në krye të *Bllokut*, ish-“Qyteti i ndaluar” i Tiranës, zona e vjetër e pushtetit me vila dhe ndërtesa të ulëta, ku kanë

banuar drejtuesit komunistë. Përpara tyre atje banonin hierarkë dhe industrialistë italianë dhe, më përpara tyre anëtarët e oborrit të vogël të Mbretit Zog. Vilat e hijshme stil vitet njëzet janë zhdukur pothuajse, në vend të tyre janë ndërtuar pallate të larta me xham e beton, hijerënda, në të cilat banojnë ata që kanë para, për të mundur të banojnë aty: biznesmenë, drejtorë gazetash, botues, mjekë dhe dentistë të klinikave më të mira private, udhëheqës politikë, njerëz me peshë me një fjalë. Në rrugë, përpara kafeneve shik baresin bijtë e kësaj shoqërie, sypishë, pak si prindërit e tyre, veshur elegantë. I vështroj, vërej vajzat, magjepsëse, të hajthme, sensuale, lejtekle mbi taka të larta: kushedi cila është arsyeja përse këtu shoh gratë më të bukura të Evropës.

Nga ato vila të pakta mbetur ende në këmbë, disa i përkasin ende shtetit, të tjera janë kthyer në bare, përgjithësisht të zbuluar me shije, të gjithë gjithnjë mbushur plot, në cilëndo orë të ditës, por më tepër të natës.

- Ku do të takohemi? - më pyeti Shkrimtari në telefon. U mendova një grimë, ulur në dhomën time të marrë me qira, duke vështuar rrjetën e dendur të telave elektrike, që kapërthehej çuditshëm përpara dritares. Nga rruga vinte era e tymit të qofteve të skuqura dhe të byrekut, që nuk pushon nga mëngjesi deri në mbrëmje.

- Shihemi në *Bllok*? - propozova unë.

- Mirë... Po ku? Se *Blloku* është i madh...

Jemi në verën e vitit 2010, *Blloku* nuk quhet më kështu, rrugët kanë emrat e komunave të toponomastikës të një qyteti normal evropian të mijëvjeçarit të tretë, demokracia pas disa muajsh mbush njëzet vjet, Shqipëria është në NATO dhe shqiptarët gjenden në të gjithë botën, me një fjalë i ngjan Italisë së vitit 1965. Në Italinë e 1965-s do të dukej tepër e çuditshme të lije takim në Romë “përpara vilës së Çianos”.

Megjithatë, ndërkohë që nga ana tjetër e dritares gërvima e telave ndërpret erën e qofteve të viçit, që piqen pa ndërprerje përmbi skarë, i thashë natyrshëm Shkrimtarit të takoheshim “përballë shtëpisë së Mehmet Shehut”. Mehmet Shehu kishte qenë Kryeministër dhe numri dy i regjimit komunist për më shumë se tridhjetë vjet. Në fund, shefi i tij e hoqi qafe dhe atë. Pak a shumë siç i ndodhi Çianos.

- Mirë, nuk banoj larg prej aty, - m'u përgjigj ai dhe as atij nuk iu duk i çuditshëm apo i pavend ky pikëtakim.

I mbështetur rëndë mbi bastun, ecën lart e poshtë në trotuar, pranë murit të ulët rrethues të lulishtes së madhe të banesës së Shehut. Nga ana tjetër e rrugës është pallati sovjetik i Komitetit Qendror, dikur. Vila sot është rezidencë e shtetit, që përdoret për të pritur delegacionet e huaja, ndërsa në pallatin e stilit moskovit, në varësi të Parlamentit ndodhen zyrat e deputetëve. Shkrimtari vështroon përreth, duke thithur tymin e cigares.

- Rediani?

- Antonio?

Shtrëngojmë duart dhe shkojmë e zëmë vend tek tryezat e një bari, të vendosura përgjatë gjysmës së trotuarit. Nga ana tjetër është vila e Enver Hoxhës, e ndarë në pjesë si rezidencë e shtetit, një pjesë bar dhe pjesa e tretë është shkollë private gjuhësh të huaja. Rediani ulet mirë e mirë në karrige, përkulet të lërë bastunin në tokë dhe ndez një cigare tjetër. Fytyrën e ka të hequr, sytë të rrudhur nga tymi i duhanit.

Është shtatëdhjetë e shtatë vjeç. Kur, disa kohë më parë i kërkonte një gazetari shqiptar e mik imi një kontakt për të rindërtuar historinë e “tezave të zeza”, ai, njohës i saj si edhe i të gjitha luftërave të brendshme në partinë komuniste të vendit të tij, nuk u mendua gjatë.

- Shkrimtarin, - më tha, nga ana tjetër e telefonit.

- Por, unë nuk po kërkoj një intelektual, ose një analist... dua të flas me dikë, që ka qenë pranë ministrit të atëhershëm, që e ka njohur nga pikëpamja njerëzore, që të dijë të më rrëfejë ngjarje; më intereson të rindërtoj periudhën e tij të fundit si ministër, kur e ka kuptuar se do ta akuzonin e do ta gjykonin.

- Mik i dashur, Shkrimtari është personi i duhur, - m'u përgjigj Apostoli nga Tirana dhe qeshi me të madhe. - Të gjithë e quajnë Shkrimtari.... kur unë e kërkonte dhe e gjeta, disa vjet më parë për një artikull, kështu ma përcaktuan dhe, sa më shumë e njihja, aq më tepër mendoja se kjo nofkë i shkonte, deri te hyrja e shkallëve të pallatit të tij. “Në cilin kat banon Redian. P.”, pyeta një grua. “Kush, Shkrimtari?”, më tha ajo...

- Dhe kush është ky Rediani?

- Redian P. ishte shoferi i ministrit të Mbrojtjes, truproja, hija e tij. Ai është një i shpëtuar nga mrekullia. Në atë kohë, kur spastrimi zhdukte ndonjë drejtues, pas tij dënoheshin edhe familjarë e bashkëpunëtorë,

sekretarë e shoferë. Enveri nuk i besonte më askujt nga rrethi i tij. Ky duhet të ketë pasur ndonjë mbrojtje. Më ka folur për një mik në Ministrinë e Brendshme...

- Përse e quajnë Shkrimtari?

- Sepse po shkruan një vepër të veçantë, të paktën për në Shqipëri... - dhe Apostoli ia plasi gazit përsëri. - Një enciklopedi... të *Formula Uno*-s. I kam shkuar në shtëpi, ngado ka revista dhe libra rreth këtyre makinave. Kishte qenë gjithnjë i pasionuar pas tyre, por andej nga fundi i komunizmit filloi të shkruante, më tregoi mijëra faqe të daktilografuara me makinë shkrimi. Kur erdhën emigrantët nga jashtë i sollën materiale dhe filloi edhe t'i përkthente me fjalorë nga anglishtja, gjermanishtja, nga italishtja, si të mundej dhe shkruan paprerë. Më foli edhe për një projekt të tijin për një itinerar të *Formula Uno*-s në Shqipëri. Dhe e di pse? Duhet të ketë hequr shumë asokohe dhe kjo i shërben për të mos u fundosur në ato histori të vjetra, për të mos e kthyer kokën mbrapsht gjithnjë në ato vite, në ato fantazma.

Pra, nuk do të jetë shumë e lehtë ta nxis të më tregojë për ministrin e tij.

Pas shkarkimit të ministrit, Redian P. vazhdoi të punonte shofer me drejtorë të departamenteve dhe të reparteve të Ministrisë së Brendshme. Pasagjerët e makinës së tij ishin ndërruar, kishte ndryshuar dhe ai. Nuk deshi më të lidhej me asnjërin prej tyre, i merrte dhe i shpinte në destinacion, asgjë më tepër; kur zyrtari donte patjetër ta qeraste me një kafe, ai mezi pranonte dhe qëndronte gjithnjë i mënjanuar.

- Një dhuratë krejt e vogël nga Italia, - i them dhe i jap një pako. Ai e hap dhe vëren titujt.

- Ah, edhe ti e ditke se jam i dhënë pas *Formula Uno*-s... Shumë faleminderit... - Shqyrton datat, shfleton në fillim numrin e *Reale Automobile Club d'Italia* të vitit 1933, me një reportazh për *Gran Premio di Monza*, pastaj vëllimin *Storia delle corse automobilistiche* të vitit 1978.

- Nuk ishte nevoja, vërtet... Edhe pse më vjen shumë mirë për këtë dhuratë, sepse po shoh që nuk e kam keq dhe koleksionin tim: të dyja këto i kam... Eh, po nuk kishe si ta dije... pastaj, janë më të mbajtura mirë se ato të miat, - thotë për të më ngushëlluar. E mbyll revistën dhe i bie shkurt: - Pse më ke kërkuar?

- Po bëj një studim mbi ministrin shqiptar të Mbrojtjes, të cilin e ekzekutuan në mesin e viteve shtatëdhjetë.

- Ai ishte gjeneral, duhet të flasësh me ndonjë ushtarak të asaj periudhe. Jo me mua.

- Redian... ti ke qenë shoferi i tij për më shumë se njëzet vjet...

- Çfarë ke ndër mend të shkruash për të?

- Akoma nuk e di... ndoshta një tregim...

Rediani vazhdon të mbajë kokën ulur dhe të më vështrojë vjedhurazi, me qepallat gjysmë të mbyllura pas tymit të cigares, që e shtrëngon fort në buzë. I vendos një mbi një revistën dhe librin, vret mendjen, duke u përpjekur ta vërë sa më në qendër librin mbi revistën me kopertinë bardhezi.

- Nuk më pëlqen të tregoj. Nuk më pëlqen as të kujtoj. Nuk më pëlqejnë as gazetarët. Më kërkojnë, herë pas here... ndonjëri prej tyre të ka folur për mua, ë? Duan gjithnjë t'ua tregoj këtë histori.

Flet me zë të ulët, sikur ka frikë mos e dëgjojnë. Pothuajse sikur nuk dëshiron ta shohin në një tavolinë me mua.

- Dua të kuptoj si ishte jeta e një njeriu me pushtet dhe si përfundonte, kur binte në fatkeqësi, kur bëhej armik i popullit. Ministri ka qenë një figurë e rëndësishme e regjimit shqiptar. I ka parë të gjitha pamjet e atij pushteti: vilën, makinën e punës, udhëtimet jashtë shtetit dhe pastaj kufirin. Dua të di si ndryshoi, kur e kuptoi se i kishte ardhur fundi. Dhe dua të të pyes nëse e kujton herën e fundit, kur e ke parë. Ja, kaq.

Më dëgjon me kokën kthyer mënjanë, duke vështruar herë tavllën e herë për tokë dhe duke ndezur njëërën cigare pas tjetrës. Kafshon buzën, vë kokën në pëllëmbën e dorës, me shikimin ngulur mbi asfaltin e kryqëzimit dhe me mendimet që e mbytin përbrenda. Unë rri në heshtje. Pres. Një shtëllungë tymi hyn në thellësi të mushkërive. Qëndron aty, pezull, e bllokuar për një kohë të pacaktuar, një përjetësi e pastaj del. Del.

- Mua më futën në polici në vitin 1949, punoja në oficinën e ministrisë dhe, meqë më pëlqenin makinat e i ngisja mirë, me shumë siguri, më caktuan në repartin e shoferëve. Nisa punën me ministrin në 1953-shin a në 1954-ën. Isha rreth njëzet vjeç. Shpesh më qëllonte të shoqëroja edhe ndonjë të familjes së tij, djemtë, që asokohe ishin të vegjël.

Tori e njohu nga larg dhe ndjeu ta pushtonte ankthi. Fuoristrada po ngjiste të përpjetën, mes gurëve, gropave të hapura nga shirat, tufave të rritura të barit. Rediani bënte shumë dredhje për të mos përfunduar në gropat më të thella. Në ndenjësën pranë, Tori mbante mbi gjunjë almanakun sportiv, që ia kishte sjellë i ati disa ditë më parë nga Polonia. Ishte me germa cirilike, por atij i interesonin fotografitë e futbollistëve dhe ato të aksioneve të tyre më të paharrueshme, driblimet, golat me kokë, penalltitë, portierët që e kapnin në fluturim e sipër dhe e çiknin topin me dorezat e mëdha. Gati instinktivisht e futi almanakun poshtë ndenjësës, si për ta mbrojtur.

Njeriu atje tej po ecte në drejtim të kundërt të shtegut, me këmbët rrasur në këpucë të larta ecjeje në mal dhe me një bastun në dorë, me të cilin godiste zhavorrin. Edhe Rediani e njohu nga larg dhe, tek po i afrohej, ngadalësoi makinën, ndali pranë faqes së malit dhe e bllokoi “Xhipin”, për ta pritur të kalonte. Rruga ishte e ngushtë dhe me pluhur. Por, tjetri nuk u duk se e vlerësoi atë vëmendje. Përkundrazi. Ishte disa metra larg tyre, kur e theu bastunin, duke goditur me forcë trungun e një peme.

U avit te dritarja e makinës me fytyrën të kuqe gjak dhe filloi të thërriste.

- Pse ndalove, ë? Pse?
- Që ju të kalonit, shoku Mehmet, rruga është shumë e ngushtë.
- Ngaqë jam Kryeministri?

Rediani ndërkohë e kishte ulur xhamin. E vështroi pa ditur si t'i përgjigjej.

- Për këtë arsye ndalove, ashtu? Do ta bëje për një bari? - Qëndroi një çast pa lëvizur, me kokën te dritarja. - Racë qeni, - shau, duke përdorur një shprehje të vjetër turke, teksa drejtoi trupin dhe mori përsëri rrugën.

Tori ishte trembur gjer në palcë. Gjithnjë tmerrohej kur haste

Mehmetin në rrugë në *Bllok*, kur ishte i detyruar t'i kalonte pranë ose kur e shihte të afrohej nga larg, kur befas dilte nga shtëpia ose kur ai shfaqej nga dera e Komitetit Qendror dhe ia behte përballë. Nxitonte hapin, ulte kokën dhe ngrinte dorën e vogël me grushtin e mbledhur, për ta përshëndetur, siç shihte të vepronin ushtarët e *Bllokut*. Kishte dëgjuar të thuhej se ishte njeri nervoz, i ashpër, madje tepër i ashpër, nuk duhej kurrë ta nevrkosje, “Kur nxehet, shoku Mehmet bëhet si kafshë”. Kështu, kur e mendonte, i vinin ndër mend tigma, luanë, gorilla, krokodilë, të gjitha kafshët e egra që i ngjethnin mishin, e linin gojëhapur, si atëherë në sallën e madhe të klubit sovjetik, ku kishin parë “Tarzanin e xhunglës”. Por, nuk kishte shpëtim, dy herë në ditë, të paktën, i duhej të kalonte midis shtëpisë së Mehmetit dhe Komitetit Qendror, njëra përballë tjetrit, në mëngjes kur shkonte në shkollë dhe në mesditë kur kthehej. Kështu, më e pakta, dy herë në ditë i kujtoheshin bishat e egra dhe Mehmeti, duke u lutur me vete të mos e takonte.

Në të vërtetë nuk e kishte parë kurrë të nxehej, përpara kësaj here në shtegun e ngushtë që i ngjitej Dajtit, por as e kishte parë ndonjëherë të qeshte apo të buzëqeshte. Dhe disa herë gjërat të paralajmërojnë vetë. Pastaj, fëmijët e ndiejnë më përpara e më mirë se të rriturit.

Tori u kthye dhe shikoi ballin e Redianit të mbuluar me djersë. Futi marshin e parë, fuoristrada u shkund në mënyrë të çrregullt dhe motori u shua. Redianit nuk i kishte ndodhur kurrë më parë. Dhe dora me të cilën po rrotullonte çelësin për ta rindezur “Xhipin” po i dridhej.

Në pllajë shoferi e ndaloi makinën në një hije, nën gjethet e pemëve dhe nxori topin nga bagazhi.

Rediani dukej i tronditur dhe i shqetësuar. U largua nga njëzet metra dhe gjuajti goditjen e parë, por aq dobët sa Tori shikoi dhe e gjuajti pa pasur nevojë të rendte për të ndaluar topin. E ktheu mbrapsht, por Rediani e hodhi tej mbi bar. Vrapoi ta merrte dhe, kur po e vendoste në tokë, Tori i doli përpara.

- Nuk ke qejf, apo jo? As unë, - tha fëmija, duke marrë topin dhe duke e futur nën krah.

Rediani vetëm tundi kokën.

- Kthehem. Pimë një limonadë te rruga jonë dhe më çoj në shtëpi.

Shoferi mbeti një çast i shtangur, duke e vështruar, pastaj pohoi me kokë dhe të dy u futën në fuoristradë.

Atë mbrëmje, përpara se i ati të hapte librin, Tori deshi t'i tregonte për ndodhinë e mëngjesit, ndërsa Senela rrinte ulur në dysHEME dhe tundte kukullën.

- Babi, babi, e di se çfarë na ndodhi sot në mëngjes?

- Çfarë ju ndodhi?

- Babi, një gjë shumë e frikshme. Shumë, me të vërtetë. Nuk po bëj shaka, - tha Tori dhe u ngrit në këmbë në shtrat e tundi duart fort. - Takuam Mehmetin, eh, domethënë shokun Mehmet.

Ministri qeshi me të madhe.

- E pastaj? Shoku Mehmet nuk të kafshon.

- Por, ai ulërin, babi... Bërtet me sa ka fuqi, - e kundërshtoi Tori.

- Babi, dëgjo, - ndërhyri Senela, për të tërhequr dhe ajo vëmendjen.

- Jam unë që po tregoj i pari. Uf, flitet me radhë, apo jo! - tha i vëllai, i zemëruar.

- Sigurisht, me radhë. Tani do flasë Tori, sepse filloi ai i pari dhe pastaj e ke ti radhën, Senela.

- Po, sepse Ferideja sot më vuri të bëja brumin dhe unë...

- Mjaft, Senela, mjaft.

Babai rrahu duart mbi këmbë dhe Senela iu hodh në krahë e iu ul në gjunjë e urtësuar.

- Po pse bërtiti shoku Mehmet? Bëre ndonjë gabim? - pyeti Torin më me seriozitet, me një gjysmë buzëqeshje mbetur në fytyrë nga e qeshura e pak sekondave më parë.

- Asgjë, babi. Po të them asgjë prej gjëje, - u përgjigj Tori, i prerë, i krekosur, me një pamje në fytyrë, që kërkonte ta besonin dhe preu ajrin me dorë, për të nënvizuar fjalën "asgjë". - Dhe as Rediani nuk bëri asgjë të keqe, të betohem. Por, Mehmeti... shoku Mehmet, i bërtiti atij, sepse Rediani ndaloi makinën, që ta linte të kalonte dhe ai nuk donte që të ndalonte dhe i ulëriu që ndaloi, sepse ishte ai vetë dhe se nuk duhet ta bënte më kurrë... Por, a e di, babi, se nuk e kuptova këtë gjë? Ma shpjegon? Rediani iu soll shumë mirë. Pse shoku Mehmet u mërzit, që Rediani u soll shumë mirë? Dhe pastaj e quajti racë qeni.

- Eh, sepse shoku Mehmet dëshiron që ta trajtojnë si të gjithë njerëzit e tjerë. Dhe kjo është një gjë e drejtë, ta dish. Njerëzit janë të gjithë të barabartë...

- Po atëherë, pse e quajti racë qeni?

- Nuk e di. Nesër, kur ta takoj në zyrë, do ta pyes. - Dhe zgjati dorën drejt tavolinës, për të marrë librin.

- Tani më takon mua, babi. Ferideja më tha se, kur e bëj unë brumin, ai vjen më i butë. Shkuam të blinin miellin dhe unë e ndihmova ta mbante, sepse ajo është e moshuar dhe lodhet menjëherë. Ecën pak e ndalon, ecën pak e ndalon.

- E gjora Feride, është e moshuar dhe e trishtuar, - ndërhyri Tori.

- Pse është e trishtuar Ferideja? - pyeti babai.

- Për Tukun, - u përgjigj fëmija dhe u pendua menjëherë që e tha.

- Për Tukun?

Tori kafshoi gjuhën dhe uli kokën.

- Nuk e di kush është, por Ferideja qan për të.

Shumë e shumë vjet më vonë Tori do ta kuptonte mirë peshën e fjalëve që u kishte thënë në fshehtësi Ferideja. Do ta kujtonte ndjesinë që provoi si fëmijë, kur e përfytyronte Tukun të fshehur në bodrum nga gruaja e moshuar ose në pyll, nën gjethet e dendura të një lisi, për ta mbrojtur nga kërcënimet e një lugati. “Tuku ishte njeri i mrekullueshëm, por, mos i thoni gjë asnjëri!”, “Tuku nuk mund të ketë bërë asgjë të keqe, ishte aq i mirë...”, thoshte Ferideja. Kur u rrit, Tori do të zbulonte se shërbyesja e fëmijërisë së tij, përpara se të vinte në shtëpinë e tyre kishte shërbyer në vilën e Tuk Jakovës. Dhe do të mësonte se ai personazh misterioz nuk ishte gëlltitur nga lisi e as nga ndonjë magji. Por, nga akuza për tradhti. Ajo plaka, gjë që do ta kuptonte shumë më vonë, kishte qenë njeriu i parë që ai kishte dëgjuar të fliste keq kundër sistemit komunist shqiptar.

- Por, e kisha unë radhën... - u hodh Senela. - Dhe nuk është e vërtetë që është e mërzitur, ajo më rrëfen shumë përralla të bukura, kur bëjmë brumin bashkë, po edhe më vonë, kur rrimë ulur përpara furrës dhe shohim të piqet. Të të sjell një copë? Do ta provosh, babi? - e pyeti vajza e vogël, duke e vështuar nga poshtë.

- Më vonë, kur ju të bini në shtrat, do të ha darkë me mamën dhe do t'i themi Feridesë të ma sjellë bukën që ke bërë ti. Dhe nesër në mëngjes, kur të zgjohemi, do të të them sa shumë më ka pëlqyer. Ta lexojmë librin, tani?

- Po, po, lexoje, - thirri më në fund Tori, i cili u shtri përmbys mbi shtrat, duke shtyrë me këmbë nënkresën dhe duke e parë babanë në sy, me fytyrën në dy pëllëmbët e duarve të mbështetura mbi bërryl.

- Pra, mbrëmë treguam se si Guliveri i shoi flakët që po shkatërronin pallatin e mbretit... në ç'mënyrë?

- Duke bërë çiqin mbi to! - u përgjigj Senela.

- Edhe unë e dija, - u ankua Tori.

-...ky fakt, edhe pse e shpëtoi mbretërinë e Liliputëve, u quajt nga perandoresha si një fyerje e madhe ndaj nderit të saj. Dhe vërtet, ajo shkoi e ndenji në qoshen më të largët të pallatit, ku, sipas saj, duke qenë cepi më i largët nga zjarri, nuk ishte prekur nga çiqi.

"...dhe mua më pëshpëritën në vesh, - tregon Guliveri, - se ajo u betua përpara njerëzve të saj të afërm se do të hakmerrej."

Kështu, prej asaj kohe, gjërat për të filluan të mos shkonin mirë. Një natë, një person i rëndësishëm erdhi dhe e takoi në fshehtësi të madhe, pra pa u pikasur nga askush. Dhe i tha se Oborri po thurte plane për ta futur në burg ose edhe për ta vvarë.

"Duhet ta dini, - i tha ky person i rëndësishëm, - se kohët e fundit janë thirrur në sekret të madh disa mbledhje të Këshillit për të diskutuar rreth jush: dhe dy ditë më parë Madhëria e Saj ka marrë vendimin përfundimtar..."

- Çfarë vendimi, babi? - pyeti Tori.

- Akoma nuk e di. Ta lexojmë. *"Ju e dini se Skyresh Bolgolami, admiral i madh, ka qenë armiku juaj për vdekje, që ditën e parë. Nuk e di çfarë arsyeje ka pasur që në fillim, por, pa dyshim urrejtja e tij është rritur nga fitorja e madhe ndaj Blefuskut, e cila i ka hedhur hije lavdisë së tij si admiral. Pra, ky zotëri, në bashkëpunim me Flimnapin, ruajtësin e madh të thesarit, me gjeneralin Limtok, me shambelanin Lalkon dhe me gjykatësin e lartë, Balmufin, kanë përgatitur akuzat kundër jush për tradhti dhe për krime të tjera të rënda..."* Në këtë pikë Guliveri e kuptoi se ishte në rrezik të madh dhe se duhet të vendoste çfarë të bënte, - tha ministri, duke trashur zërin.

- Ai duhet të ikë prej andej sa më parë, babi, po deshi të shpëtojë. Në qoftë se e akuzojnë pa të drejtë, mendoj se do bëjë mirë të arratiset në Blefusk.

Ministri e vështroi i menduar, pak i turbulluar. Mendoj për repartet e tij të dërguara në kufi, pikërisht për të kapur ata që kërkonin të arratiseshin; kishte zgjedhur ushtarët më të vendosur e komandantët më të mirë për këtë shërbim. "A është e drejtë të arratisesh?", befas

pyeti veten ai, që ishte dhe ushtarak. Por, arsyetimi i fëmijës i vërtitej në kokë.

- Nuk është e drejtë të arratisesh nga vendi yt, - u përgjigj.

- Babi, çfarë po thua? Liliputi nuk është vendi i Guliverit.

- Ah, e vërtetë... atëherë. Këshilltari i Oborrit, që shkoi te Guliveri, pasi mbaroi së numëruari akuzat e përgatitura nga ministrat e mbretit kundër tij dhe dënimin përkatës, i tha: *“Po ia lë urtësisë suaj vendimin për masat që duhen marrë dhe, për të shmangur dyshimet po largohem menjëherë po me atë fshehtësi me të cilën erdha.”* Zotëria e Tij u largua në çast dhe unë mbeta vetëm, me kokën plot dyshime e turbullira...”

- Çfarë do të thotë “turbullira”?

- Do të thotë pasiguri, do të thotë se ishte i turbullt në mendje. Pra, në këtë pikë Guliveri nuk dinte çfarë vendimi të merrte.

- E lehtë fare: ose të shkatërrojë Liliputin, se ai është shumë më i fortë, është gjigand. Ose të arratiset.

- Po... atëherë. *“Sipas një ligji të caktuar nga princi dhe ministrat e tij, pasi Gjykata shpall dekretin për ndonjë ekzekutim mizor për të kënaqur zemërimin e mbretit ose ligësinë e të përkrahurit të tij, perandori mbante gjithnjë një fjalim në Këshill për të nxjerrë në pah zemërgjerësinë dhe ndjeshmërinë e tij të madhe, cilësi që të gjithë ia njihnin dhe ia çmonin. Fjalimi bëhej i ditur menjëherë për publikun në të gjithë mbretërinë dhe asgjë nuk e tmerronte më tepër popullsinë se kjo lëvdatë e mëshirës së Madhërisë së Tij, sepse kishin vërejtur që sa më të mëdha e më këmbëngulëse të ishin këto mburrje, aq më çnjerëzor ishte ndëshkimi dhe aq më i pafajshëm ishte ai që e vuante. Një moment mendova ta përballja gjyqin, sepse, ndonëse nuk mund t'i mohoja faktet e kundërshtueshme në shumë nga akuzat, gjithsesi shpresoja se donin të më jepnin disa lehtësime. Por, gjatë jetës kisha qenë dëshmitar i shumë gjyqeve të shtetit, ku kisha parë të përfundonin ashtu si donin gjykatësit dhe nuk isha i bindur të merrja një vendim kaq të rrezikshëm përballë një situatë kaq kritike dhe përballë armiqsh kaq të fuqishëm...”*

- Pse ndalove, babi?

Ai kishte ndaluar së lexuari, sepse po rilexonte me mendje dy paragrafët e fundit. Pastaj e ktheu librin. Xhonatan Suift (1667-1745)

- Sepse është vonë. Për sonte e lëmë këtu. E vazhdojmë nesër.

- Për mua, ai ikën, - tha Tori.

NATA E TË MUNDURVE

- Natën e mirë, gjumë të ëmbël! - I puthi fëmijët, u ndreqi çarçafët dhe doli, duke mbyllur derën ngadalë.

1667-1745

5

Tiranë, 20 qershor 1974. E enjte.

Disa vjet pas emërimit të të shoqit si ministër, në fillim të viteve pesëdhjetë, i caktuan të banonin në atë zonë. Shokët udhëheqës i takonte në rrugë çdo ditë dhe kjo i mjaftonte. Kishte vënë re se, kur në Parti ndihej ndonjë kundërshti shokët zymtoheshin, ecnin të përkulur, disa haptazi të trishtuar, me fytyrën e nderë, si të përfytyronin duele; disa shfaqeshin të dobësuar, të lodhur, të dëshpëruar, ndërsa të tjerë bëheshin dyshues, ruanin krahët, madje edhe guximtarë. Edhe ajo u shmangej syve të tyre. Ata vështronin përdhe, të brengosur, ose të gatshëm për betejë, ecnin drejt shtëpive të tyre ose drejt zyrave pa e ngritur as kokën, rrugën e dinin përmendësh, fundja. Mehmeti bënte pjesë në ata që shtrëngonin dhëmbët e studionin planet e betejës. Bashkëshorti i saj, përkundrazi, ulte kokën.

Për herë të parë e kishte vënë re këtë metamorfozë të tyre disa muaj përpara goditjes së Tuk Jakovës. Nuk i dha shumë rëndësi. Pastaj, përsëri, disa vjet më vonë, kur futën në burg Liri Belishovën. Në këtë rast të dytë e lidhi për herë të parë ndryshimin në sjelljet e tyre ndaj një konflikti të brendshëm të grupit udhëheqës. “Lufta e klasave” kundër Lirisë, *pasionares* së Partisë shqiptare u futi të gjithëve dridhmat. Vuri re heshtjen e hidhëruar të të shoqit dhe kuptoi se edhe shokët e tjerë që takonte rastësisht nëpër rrugët e *Bllokut* ose që i shihte të hynin në makinat e zeza, lëviznin si automatë të përhumbur. Kjo gjendje u rikthye edhe plot herë të tjera, deri një vit më parë, kur në telashe ranë Todi dhe Fadili.

I vetmi që ruante në dukje një farë ekuilibri ishte Hysni Kapoja, më i paqmi midis shokëve drejtues. Rasti e solli të banonin pranë e pranë, në zonën e kryetarëve të Partisë. Kështu, i ndodhte shpesh të takonte Viton, gruan e Hysniut dhe të shkëmbente me të dy fjalë në rrugë e në ndonjë vizitë në vilat e tyre. Të dyja familjet kishin qenë edhe me pushime së bashku në Soçi, në Krime, për disa vjet resht.

Vitoja ishte nga gratë më elegante të *Bllokut*, por edhe të Shqipërisë. Dhe sigurisht, nuk ishte thjesht çështje veshjeje. Ajo i mbante në mënyrë të veçantë edhe veshjet më të thjeshta. Vitoja interpretonte një rol, ishte kryetare e Bashkimit të Grave të Shqipërisë, kishte për detyrë të tërhiqte pas vetes në emancipimin e gruas mijëra fshatare, punëtore, punonjëse dhe studente. Dhe i besonte verbërisht këtij roli. Ndoshta do të bëhej Gruaja e Parë e vendit, kushedi. Në fund, gjithçka, thuajse si në ditën e gjykimit universal, do të varej nga Enveri. Vetëm ai, atë ditë, do të vendoste kujt t'ia linte pushtetin, Mehmet egërsirës apo Hysniut, hijes së tij. Dhe atëherë, nëse vendimi do t'i binte të shoqit, kjo punë në sektorin e grave, më i prapambeturi në Shqipërinë e Re, do të përbënte një biografi për shoqen e jetës dhe të punës së udhëheqësit të ri. Kjo perspektivë e rigjallëronte, i jepte forcë të re, e nxiste të projektonte nisma të reja dhe të udhëtonte nëpër Shqipëri paprerë. Vitoja u prishte punë, me këto gratë. Më së pari, i prishte punë Mehmetit, të cilit i duhej të miratonte projektet e saj dhe t'ia financonte. Dhe, Mehmeti, edhe ai, rrallëherë mund të thoshte jo. Kjo aftësi e shkathtësi e saj e bënte të besueshme dhe të admiruar. Në sytë e gruas së ministrit dhe jo vetëm të saj, ajo dukej e drejtpërdrejtë, e shpejtë, e sinqertë.

Për shkak të kësaj aftësie atë natë vendosi të shkonte e të takonte Viton të nesërmen, për të kuptuar se mbi kë do të hidhte Enveri rrufetë e tij kësaj radhe.

Po, mbi kë?

Kush mund të ishte? E përjashtoi menjëherë Mehmetin dhe Hysniun, nuk ndali as edhe një grimë mbi këto mundësi. Pra, kush po e dëshpëronte aq shumë burrin e saj? Vetëm një herë e kishte parë kaq të mërzhitur. Kur akuzuan Tukun, që e kishte mik. Vuajti, sepse e pa të zhdukej pa mundur të bënte asgjë. Gruaja e ministrit e kishte kuptuar me kohë se për shumicën kjo ishte arsyeja kryesore e vuajtjes, pamundësia për të mbrojtur shokun pa rrezikuar vetë jetën e tyre. Madje, secili ishte i detyruar të dëshmonte kundër tij. Enveri dhe dymbëdhjetë shokët e tjerë të Byrosë Politike kishin të gjithë të njëjtin stil dhe të njëjtën metodë kur hetonin, por, kur më pas procesi kalonte përpara njëqind anëtarëve të Komitetit Qendror, grave dhe burrave të të gjitha kategorive, të të gjitha qarqeve të vendit, të çdo niveli arsimor, shpërthente gara e shëmtuar për të goditur viktimën me gurë. Drejtuesit e Partisë, të cilët e kishin

akuzuar ata vetë shokun e tyre, merrnin pjesë në veprën përfundimtare nga ana e kooperativistëve të paditur, të kryetarëve gjysmë analfabetë të fshatrave, të drejtuesve ambiciozë e të zyrtarë lokalë, që vërsuleshin si skifterë mbi prenë dhe e sflitnin pa mëshirë, e godisnin, të etur të bënin figurë të mirë në sytë e shokut Enver, të cilin e brohorisnin, po edhe i trembeshin. Ideja se mund të gjendeshin në këtë shfaqje bishash të egra, të lira e të shfrenuara përreth një viktime të pafuqishme e të vetmuar, e trondiste shumicën e grupit udhëheqës, i shqetësonte më të ndjeshmit, i bezdiste më të ndërlikuarit.

Me kohë, me përvojën e fituar duke marrë pjesë e duke i ndihmuar këto gjyqe, edhe më emocionalëve u trashej lëkura. Në fund të fundit ishin njerëz me pushtet. Dhe secili prej tyre e dinte se çdo koleg do ta ruante si thesar të fshehtë çdo hap të gabuar të dikujt tjetër, një shkarje goje, një frazë që shpëton pa u menduar: do ta kyçte në mendje, do ta arkivonte në kujtesë, për ta përdorur si armë sulmi apo mbrojtjeje, sipas rrethanave. Dhe kështu, edhe në Shtëpinë e Partisë, edhe në mbrëmjet në të cilat Enveri nuk vinte dhe përreth tryezave të lojës ose të bilardove ku takoheshin nga dy e nga tre, të gjithë ishin syhapët, të vëmendshëm, për të mos humbur asnjë fjalë nga ato të të tjerëve dhe për të mos shqiptuar asnjë fjali të vetme, që nuk do të tingëllonte mirë.

Në këtë situatë ishte shumë e vështirë lindja e miqësive të vërteta dhe ajo e dinte mirë këtë. Megjithatë, atë mbrëmje pyeti veten se për cilin prej tyre i shoqi mund të ndiente dhimbje. I kaloi në mendje të gjithë me radhë dhe të gjithë i përjashtoi. Por, ai dukej i hidhëruar njësoj si atëherë për Tukun dhe kurrë nuk e kishte parë të vuante ashtu, as për Lirinë, as për Temen dhe, një vit më parë, as për Todin e Fadilin. Në qoftë se kjo kishte ndodhur, sepse Tuku ishte miku i tij më i ngushtë, do të thoshte se tani po i vinte radha një tjetër mikut të tij të vihej nën akuzë. Por, kush? Ai prej vitesh nuk rrinte më me askënd në veçanti. Prej shumë kohësh mbante vetëm marrëdhënie të mira me të gjithë, me dikë më shumë e me dikë më pak, sipas interesave dhe natyrës së tyre, por asgjë përtej kësaj. Në mbrëmje, prej vitesh tashmë, më mirë parapëlqente të shëtiste dy hapa me Redianin, pas darke, në trotuarin përjashta *Bllokut*, sepse ia kishte këshilluar mjeku dhe sepse ministrit të Mbrojtjes nuk i shkonte ai bark aq i madh.

Por, nëse vuajtja për Tukun lidhej dhe me mungesën e eksperiencës, meqë kishte qenë gjyqi i parë ku kishte marrë pjesë, gjë që kuptohet, e tronditi gjeneralin e sapoemëruar ministër dhe, nëse gjyqet e mëtejshme arriti t'i përballonte me më shumë forcë, pikërisht sepse ishte i përgatitur... përse tani kishte rënë në dëshpërim aq të thellë?

U ul befaz në shtrat. Ishte mbushur në djersë. Vuri një rën dorë mbi supin e të shoqit, të kuptonte nëse po flinte. Ai nuk lëvizti. Ngadalë, ajo shtyu tej çarçafin, kërkoi pantoflat me këmbë dhe doli nga dhoma pa bërë zhurmë.

Në kuzhinë, me gotën e ujit në dorë, përpara dritares anësore të vilës së tyre filloi të mendonte përsëri për gjithçka. Shtyu perden dhe po në atë çast vuri re mungesën e “Zilit” të ministrisë. Pamja e kalldrëmit iu duk e pazakontë: zakonisht Rediani e linte aty, gati për punët e nesërme. Sigurisht, herë pas here, makina kishte nevojë për mirëmbajtje ose për ndonjë riparim dhe shoferi e shpinte në oficinë. Me siguri, edhe sonte kështu shpjegohej mungesa e saj. Megjithatë, u turbullua dhe pati një parandjenjë të keqe.

I hoqi sytë nga zhavorri i bardhë, i ndriçuar nga llambat e rrugës dhe u kthye me kurriz nga dritarja. “Sa budallaqe jam...”, tha me vete. “Përse ta kenë marrë inat? Ai nuk i bën kurrë keq njeriu. Dhe nuk i intereson karriera. Nuk ka më asnjë ambicie... Është i lodhur. I ka ardhur në majë të hundës. Kërkon të japë dorëheqjen. ...Në qoftë se e duan vendin e tij, mjafton ta nxjerrin në pension, e ai do të jetë shumë i lumtur...” Piu një gllënjë ujë, e shpërlau gotën dhe e vendosi te kulluesja e enëve. Pastaj u kthye në shtrat.

Të nesërmen, pasi u bë gati, shkoi te studioja e të shoqit vetëm një çast, sa për ta parë të përkulur mbi shkrimore, me syzet në majë të hundës dhe i tha:

- Po shkoj te magazinat. - Mbylli derën dhe doli.

Ministri nuk pati kohë as të ngrinte kokën dhe nuk ia pa flokët e krehur së shoqes, e cila kishte kohë që nuk i krihte ashtu, as nuk vuri re se kishte nxjerrë nga rafti një kostum ngjyrë arre, tanimë të harruar dhe këpucët me lustër.

Përmes vetratës së verandës e pa tek vinte nëpër rruginën e brendshme të *Bllokut* dhe i doli përpara, duke bërë sikur ndodhej

rastësisht aty. Dinte shumë mirë të mos e shfaqte gjendjen shpirtërore e shoqja e ministrit. Po edhe Vitoja, po aq mirë.

- Vito! Si je? Më vjen mirë që u takuam. Se kemi shumë kohë... Si është Hysniu? Po fëmijët? - Fjalët e zakonshme të mirësjelljes. - Po puna si shkon?

Vitoja ishte e sjellshme, buzëqeshëse. U tregua jashtëzakonisht normale. Por, nuk e ftoi të hynte në shtëpi për një kafe ose për një ëmbëlsirë të lehtë. Dhe kjo ishte e vetmja gjë jo e zakonshme nga sa mund të parashikohej.

Edhe Vitoja bëri pyetjet e zakonshme dhe, kur e pyeti si ishte i shoqi, ajo nuk e humbi rastin.

E luajti mirë pjesën. Sikur nuk kishte kaluar enkas andej dhe u përgjigj krejt natyrshëm:

- Oh, Vito e dashur, nuk është mirë, në këtë moment. Por, ndoshta e ke vënë re dhe ti...

- Jo, se ka ca kohë që nuk e kam parë. Kam qenë disa herë jashtë shtetit, në vendet e Lindjes, këtë periudhë, kam qëndruar shumë pak në Tiranë... Pse, çfarë ka?

- E shoh të shqetësuar, të mërzhitur... Ti e di si është ai zakonisht, apo jo? I gëzuar, gjithnjë me shokë. Tani o flet pak, o nuk e hap gojën fare. Ndoshta ti mund të dish se çfarë po ndodh...

- Oh... ti e di dhe vetë, ne merremi me fusha shumë të ndryshme, ai në atë ushtarake, unë në fushën e grave... E çfarë të të them? Nuk e di... I shqetësuar... Nuk mund ta di se për çfarë, por e kuptoj se sektori i tij është shumë delikat.

- Atë nuk e tremb puna. Ka ndonjë ngërç, dihet, por ai nuk zbrapset nëse i duhet të punojë më shumë apo të zgjidhë ndonjë çështje në zyrë... Ndërsa kësaj radhe... nuk e di... - E vështroi drejt në sy: - Tek ty kam besim, Vito. Mos po ndodh gjë në Parti?

Vitoja uli sytë poshtë. Kafshoi buzën. I ndryshoi shprehja e fytyrës. Syrit të gruas së ministrit nuk i shpëtuan këto ndryshime.

- Burri yt është ministër i Mbrojtjes. Mund të ketë shqetësime, edhe të rënda, për shumë arsye. Mund të ketë informacione të rezervuara, që i dinë vetëm bashkëpunëtorët më të afërt të Enverit. Po pse mendon se mund të jetë duke ndodhur diçka në Parti?

- Vetëm një herë, shumë vjet më parë, e kam parë në këtë gjendje. Atëherë pyeta Gogon, me të cilin kishte shumë miqësi. Dhe Gogoja më tha të mos shqetësohesha, se po punonte më tepër dhe ishte pak i lodhur... Më qetësoi. Pastaj mësova për Tukun, që e kishin përjashtuar nga Byroja Politike dhe për gjithçka tjetër rreth tij. Të pyes, sepse tani ai është njësoj si atëherë... Ndoshta shoku Hysni të ka thënë ndonjë gjë...

- Hysniu nuk më vë në dijeni të çështjeve që lidhen me Byronë Politike, - u ngurtësua Vitoja. Po pastaj buzëqeshi përsëri. - Rri e qetë. Nuk ka asgjë për burrin tënd. Ndoshta vuan për ndonjë mik... Do t'i kalojë, ke për të parë.

Gruaja e ministrit e mori përgjigjen që donte. Dhe e kuptoi fare mirë. Në Parti kishte një problem të ri, por ai nuk lidhej me të shoqin. Oh, Zot! Edhe kjo do të kalonte. U çlirua.

- Oh, faleminderit, Vito! Pa dyshim kështu është, si thua ti. Po pushimet nga do t'i kaloni?

- Eh, e di ti si është Hysniu... Po nuk e tërhoqa unë me zor ta ndërpresë pak punën, ai do të punonte gjithë vitin, dymbëdhjetë muaj... Do të shkojmë në Durrës, në fund të korrikut. Pastaj në Pogradec. ... sepse i duhet të diskutojë disa çështje me shokun Enver përpara shtatorit. Të më falësh, se jam me ngut. Kam një mbledhje në komitetin e Partisë pas dy orësh dhe shpresoj të më dalë koha sa të ha një kafshatë... - Ia mori duart në të sajat, i buzëqeshi përsëri me kokën e përkulur dhe, pasi e përqafoi, hapi derën e vogël të oborrit dhe ngjiti shkallaret deri te dera e madhe e hyrjes.

Ajo qëndroi disa çaste me sytë ngulur te porta e mbyllur. Përsëri, diçka e turbullonte, por nuk e kuptoi menjëherë se çfarë. Eci përgjatë trotuarit, drejt magazinës së *Bllokut*. Do të merrte dy shishe qumësht dhe një bukë. Nuk i vinte tjetër gjë në mendje, edhe sepse, në vend të mendonte se çfarë mungonte në shtëpi, kërkonte brenda vetes arsyet e këtij ankthi të ri.

"Nuk ka asgjë për burrin tënd." E gjithë biseda me Viton kishte përfunduar te kjo frazë e vetme. "Nuk ka asgjë për burrin tënd", pra, përsëri po ndodhte diçka, por ai nuk kishte lidhje. U mundua të kujtonte atë ndjesinë e lehtësimit që pati kur e dëgjoji dhe deshi ta ripërjetonte, për ta ruajtur. Por, nuk mundi. Çfarë nuk shkonte mirë? Ajo frazë ia kishte

gëzuar aq fort zemrën, sa e kishte pyetur me çiltërsi për programet e tyre të pushimeve për atë verë. Ndoshta kishte dashur që Vitoja t'i fliste më shumë, ta qetësonte edhe më, ndoshta kishte dëshiruar t'i tregonte se për kë po ndodhte ajo diçkaja. Kishte dashur të merrte vesh prej saj se për kë po vuante aq shumë i shoqi. Por, Vitoja, po t'i tregonte më shumë, do të shkelte rregullin. Do të nxirrte të shoqin, Hysniun, në një dritë jo shumë të pranueshme: nga kush do t'i dinte ato informata Vitoja, përveçse prej tij, i cili, në shtëpi, në fshehtësi, i rrëfente gruas çështje të rezervuara, madje të rrezikshme. Jo, Vitoja nuk mund t'i thoshte më shumë: këto gjëra nuk ishin thashetheme grash. As Vitoja nuk ishte grua që merrej me fjalë. Dhe, as ajo vetë. U përpoq të gjente përsëri atë qetësinë e shkaktuar nga fraza e vetme e rëndësishme e Vitos. Dhe u përpoq të dëbonte mendimet e këqija: “Po ne, ku do të shkojmë me pushime sivjet?”, pyeti veten. Mendimet i erdhën me shpejtësi. “Djemtë do të shkojnë ku të duan ata.” Por, për të shoqin nuk duhej deti. Ai kishte nevojë për qetësi. As liqeni: në Pogradec do të ishin dhe Enveri me Hysniun, pra punë... “Ai ka nevojë të çlodhet, të flejë, të boshatisë mendjen. Pllaja e Thethit, në Veri: edhe një dhomë në një kazermë do të jetë fare mirë.” Mendimet brodhën të shpejta dhe në fund mbizotëruan: “Përse Vitoja nuk më pyeti ku do të shkonim me pushime?” Dhe e kuptoi menjëherë përse i lindi ai ankth.

6

Tiranë, 2 korrik 1974. E martë.

Xhami i orës u ndriçua, akrepat lëvizën dhe formuan numrin katër. Kishte vënë zilen elektronike të zgjimit, që ishte në një kuti bojë portokalli me qoshe të rrumbullta, mbi një karrige pranë shtratit. Ishte dhuratë e kushëririt, Kryeministrit, që ia kishte kërkuar ambasadës së Parisit t'ia dërgonte. Idrizi u kthye, zgjati dorën dhe shtypi butonin prej plastike për ta shuar. Pastaj u ngrit dhe ul buzë krevatit portativ. Veshi këmishën dhe e mbërtheu me shkathtësinë e përhershme, u vështrua një çast në një pasqyrë të vogël dhe doli nga zyra. Dhjetë minuta më vonë, biçikleta e tij ishte tashmë në *Bllok*.

Natën e mëparshme kamioni i ushtrisë bëri kalimin e tij të përhershëm për të marrë ushtarët që mbaronin shërbimin e rojës por, ndryshe nga herët e tjera, nga karrocERIA nuk zbritën më rojat e turnit 23-06. Pak më vonë, dy kamionçina të Ministrisë së Brendshme përshkuan të njëjtin itinerar dhe prej tyre zbritën disa persona veshur civilë të Sigurimit të Shtetit. Kadriu, ministri i Brendshëm, kishte lënë porosi që atë natë të përforcohej mbikëqyrja dhe të mbaheshin sytë hapur, veçanërisht përreth shtëpisë së ministrit.

Kështu, Idrizi shkoi për kontroll. Në heshtjen e thellë, vringëllima e rrotave dhe e zinxhirit të biçikletës së tij ishin të vetmet zhurma. Dukej sikur e gjithë Tirana ishte në gjendje të ngurtë, e bllokuar, e pafuqishme të lëshonte tinguj, pezull në ajër, në pritje të diçkaje. Sikur i gjithë qyteti ishte fshehur diku, pa dashur të përgjonte, të mësonte apo të merrte më frymë. Po agonte. Nën atë dritë të kaltërremë, Idrizi i erdhi rrotull sheshit katror. Kontrollloi nëse rojat ishin në vendet e tyre, vëzhgoi lulishtet e vilave dhe grilat e verandave të vilave. Asnjë rreze drite nuk dilte prej tyre. Të gjithë flinin. Enveri, kushërii Mehmet, Hysniu, Ramizi, Adili... Në afërsi të çdo vile qëndronin dy deri në katër policë. Katër ata të vilës së ministrit dhe shtatë të tjerë, që gjendeshin në rrezen e perimetrit të asaj njësie të zonës. Këtu Idrizi ngadalësoi dhe pastaj

vuri njërën këmbë për tokë, për të ndaluar. Zgjati dorën e majtë, të cilën shefi i rojave ia shtrëngoi me të dyja duart.

- Gjithçka në rregull? - pyeti, duke bërë shenjë me kokë nga shtëpia e ministrit të Mbrojtjes.

- Gjithçka në rregull, - u përgjigj tjetri.

- Ndonjë lëvizje?

- Asnjë.

Idrizi lëshoi timonin dhe kërkoi paketën e cigareve në xhepin e këmishës, ia dha policit, i cili mori një prej aty. Idrizi i tundi dorën për t'i thënë nxirr dhe të tjera. Shefi i rojave tërhoqi tre dhe, duke i mbajtur në pëllëmbë, vështroi sipërorin për të kuptuar nëse kaq ishte mjaftueshëm. Atëherë Idrizi mori njërën, e vuri në buzë dhe e ndezi.

- Mbajti sytë hapur, - i tha, pastaj shkeli pedalin dhe u largua.

Ministri pa të afrohej njeriu në biçikletë, vështroi dhe rojën përpara vilës të nxirrte dhe ai çakmakun dhe të pinte dhe ai cigare; këqyri rrugën majtas e djathtas. Ishte e shkretë, përveç atij njeriu te dera e hekurt e kopshtit dhe një polici tjetër, i cili çdo dyzet sekonda hynte në fushëpamjen e të çarës së grilës tek bënte ecejake pesëdhjetë metra më tutje, me fytyrën ulur poshtë. I hodhi një shikim pjesës së pasme të vilës së Enverit. Edhe atje, atë natë, ushtari që rrinte te kopshti ishte zhdukur. Ngadalë, shtrëngoi rripin e perdes me gishtin tregues dhe me të madhin e tërhoqi pak, duke e lëshuar poshtë, shumë ngadalë, duke e ngushtuar sa më shumë atë të çarë nga hynte drita.

Në errësirë shkoi te poltrona dhe u zhyt në të. Kërkoi me dorë butonin dhe nga abazhuri u derdh një dritë e verdheme, e dobët.

- Pse nuk shtrihesh pak? - e pyeti e shoqja.

Me një tundje koke ai i la të kuptonte se ishte mirë aty.

- Çfarë do të ndodhë?

Prej një jave e mbante të ndryrë këtë pyetje, qëkurse, më në fund, kishte kuptuar gjithçka. I shoqi nuk shkonte më në ministri, rrinte në shtëpi gjithë ditën pa lëvizur, në verandë ose në studion e tij, ku shkruante faqe të panumërta, deri natën vonë. Rediani dhe makina ishin zhdukur. Dhe përpara shtëpisë ishin shfaqur dy-tre persona, pa dyshim të Sigurimit të Shtetit. Në fund, një korrier nga Komiteti Qendror kishte sjellë letrën thirrëse të Byrosë Politike. Ministri nuk e sqaroi, vetëm u mundua ta qetësonte me një shpjegim të shpejtë:

- Mehmetit nuk i ka pëlqyer një riorganizim i mbrojtjes dhe po më nxjerr probleme...

Por, ajo kishte ngulur këmbë. Nuk merrej shumë me politikë, si bënin gratë e Enverit, të Mehmetit dhe të Hysniut, por disa gjëra i kuptonte, e dinte si funksiononin. Dhe ishte treguar budallaqe, një mijë herë budallaqe, që nuk e kishte kuptuar më përpara se çfarë po ndodhte.

- Çfarë problemesh? - e pyeti, duke i qëndruar përpara, drejt në këmbë, me vështrimin e ngulët e të rëndë. - Çfarë problemesh? Çfarë do të na bëjnë? Duhet të ma thuash. Jam gruaja jote, kemi fëmijë. Duhet ta di!

Ai u gëlltit, mblodhi forcat, si të përgatitej të shqiptonte një frazë shumë të gjatë:

- Do të më bëjnë gjyq, - tha. Gruaja lëshoi një ulërimë dhe mbuloi fytyrën me duar.

- Si Todit? - thirri, e lemerisur. - Si Fadilit?

Zëri i doli i çjerrë, nga tronditja. I shoqi u afrua ta përqafonte dhe ta qetësonte, por ajo e shtyu.

- Më tha të rrija e qetë... Se nuk ka asgjë për burrin tënd...

- Kush?

- Vitoja, ajo.... Aaaa! - mundi vetëm të thërriste.

- Ke shkuar tek ajo?

- Sigurisht! Mendon se jeton vetëm, ti? Se jam e verbër? Apo budallaqe? Ke një muaj që je kështu. Prandaj shkova te Vitoja, ta pyesja se çfarë po ndodhte...

- Çfarë i the?

- Çfarë i thashë? E pyeta çfarë po të ndodhte, nëse ajo dinte diçka. Jam jot shoqe, kam të drejtë ta di, - dhe përplasi këmbën për tokë. - I thashë se nuk të kisha parë kështu prej kohësh që s'mbahen mend, qëkur zhdukën Tukul. "Nuk ka asgjë për burrin tënd", - më tha ajo e mallkuar.

- Kështu i the? Për Tukul...?

Ajo nuk e dëgjoi më. Shkoi e u ul tek tavolina e kuzhinës, me duart futur ndër flokë. Dridhej, me sytë mbyllur, me buzët shtrënguar, asnjë lot nuk i lagte fytyrën. Ishte e zemëruar dhe e tmerruar. Qindra pamje i kaluan në mendje në pak sekonda, Fadili dhe Todi, gratë e tyre, fëmijët, festat së bashku, shtëpitë e tyre të zbrazura, vetëm një vit më parë. Dhe më herët, pesëmbëdhjetë vjet më parë, Tuku, e shoqja Mita dhe fëmijët,

fytyrat e Vjosës, Agimit, Besnikut dhe Bujanës, më të voglës. I shoqi mezi e kishte marrë veten nga humbja e Tukut, kur dy vjet më vonë i ndodhi Temes dhe të shoqes, Shpresës e fëmijëve të tyre, Rajmondit e Sokolit. Të gjithë të zhdukur, të vdekur ose të varrosur në baltë. Të humbur. Të asgjësuar. Anëtarë të Komitetit Qendror dhe gratë e tyre. Gjeneralë e fëmijë. “Të gjithë!”, thirri befas, me zë të lartë. Dhe goditi me forcë me dorë mbi tryezë, duke hedhur përpjetë vazon prej porcelani. E tërbuar, e verbuar, brofi në këmbë duke rrëzuar dhe karrigen dhe vrapoi për në sallon si e çmendur. Shkoi drejt divanit, ku ai po rrinte kokulur, me fytyrën fshehur në duar. Pa e zgjatur, u ngjit mbi divan me pantofla e me të gjithë forcën e shkuli kornizën nga gozhda. Ministri ngriti kryet tamam në kohë për të parë fotografinë të shkatërrohej përtokë dhe ciflat të vërviteshin deri te dera. Të dy shtangën, duke vështuar ngultas fytyrën buzëqeshëse të Enverit poshtë xhamit të thyer, në dysHEME, ndërsa këmbët dhe duart e së shoqes, në këmbë mbi divan, ende dridheshin. Kur u qetësuan disi, hodhën shikimin nga dritarja e gjatë e verandës. Perdet ishin të mbyllura, por, për një çast ata kapën shkëlqimin e dritës mes dy cepave të harkuar, vetëm tri-katër centimetra hapësirë, nga dukeshin pemët e oborrit të Enverit. Vështuan përreth, ndonëse ishin vetëm në shtëpi dhe u ulën menjëherë të mblidhnin xhamet dhe copat e kornizës. Ai nxitoi të merrte fotografinë dhe e vari përsëri te gozhda, duke shpuar pak në qendër pjesën e sipërme të kartonit.

- Procedura do të jetë ajo e përhershme. Do të më bombardojnë me pyetje për dy ditë në Byronë Politike. Pastaj, gjithçka nga fillimi, përpara Komitetit Qendror dhe në fund... në fund me siguri do të më shkarkojnë si ministër. Dhe kjo është më e pakta.

Ajo uli sytë mbi duart e mbledhura në prehër.

- Çfarë shkrove në autokritikë?

- E çfarë të shkruaja? - u përgjigj ai me zë të ulët, por me ton pak të ngritur dhe shtyu kokën pas. - Që kam gabuar, se ata kanë të drejtë, se do të reflektoj, do të mendohem, se elementet mikroborgjeze të karakterit tim më nxitën t'i shmangesha... dhe se nuk doja të vija në rrezik Partinë, socializmin në Shqipëri, ushtrinë... ja, gjëra të tilla.

Ngriti sytë dhe e vështroi të shoqen.

- E kotë të mbrohesh, të rezistosh. Kanë vendosur për gjithçka. Unë nuk e di se çfarë fati do të kem, por ata, Enveri, Mehmeti dhe Hysniu e dinë

tanimë. Dhe, meqë i njoh dhe e di si arsyetojnë... është e kotë të mbrohem. Jam i bindur se kam bërë gjënë më të mirë. Ishin ata vetë dhe Enveri i pari, që më shtynë të zhvilloja ato teza dhe t'ia përshtatja situatës sonë. Për mua nuk kishte asgjë të keqe të parashikonim shpërndarjen vende-vende të ushtrisë, për t'iu shmangur bombardimeve nga ajri, ndërsa një vijë e parë fronti të përpiquej të pengonte armikun. Është e vetmja mënyrë për të shpëtuar mbrojtjen tonë, nëse na sulmojnë. Një ushtri e vogël... e çfarë mund të bëjë përballë ushtrisë popullore jugosllave apo përballë një zbarkimi të NATO-s? Të përpiket t'i ngadalësojë: ndërkohë që vija e parë sakrifikohet, pjesa tjetër e forcave të armatosura pozicionohet në zona të mbrojtura, në male, në lugina, për t'i sulmuar befasisht dhe, në një kohë më të gjatë, për t'ua bërë të pamundur marrjen nën kontroll të vendit. Parulla ime: "T'i shndërrojmë fushat në male", të ndërtojmë fortifikime, bunkerë në fusha, ishte lidhja midis strategjisë së mbrojtjes së përparuar dhe asaj të fshehjes në male. Enverit kjo frazë i pëlqeu dhe më dha kurajë. Do të thoshte të ngrinin gracka pas vijës së parë; kur ajo do të dorëzohej, armiku do të haste në të tjera mbrojtje, në të tjera pengesa për të kapërcyer, pengesa me teknologji të lartë, beton nga më i miri në botë, i llojit më të qëndrueshëm, i fortë si shkëmb. Enveri e kuptoi domethënien e parullës sime, një herë edhe e përdori në një fjalim... Do të thoshte të bashkonim në një strategji të vetme mbrojtjen aktive, teknikën konstruktive, më moderne dhe malet e luftës partizane.

Goditi kofshën me dorën që po lëvizte në ajër dhe ngriti sytë, duke e vështruar të shoqen, sikur po bisedonte me një strateg.

- Kjo teori imja nuk ishte mosbesim ndaj ushtrisë. Avionët tanë kurrë nuk do të arrijnë as të ngrihen, në rast sulmi. Ky është realiteti. Tjetër gjë është se çfarë themi nëpër fjalime e në parada se si jemi... dhe tjetër është ajo, që duhet të jemi të vetëdijshëm, nëse jemi njerëz të përgjegjshëm. Me atë sipërfaqe territoriale që kemi, me një ultësi rreth njëzet kilometra të thellë, apo tridhjetë e shumta, armiku mund të futet deri në gjysmën e vendit që me goditjen e parë. Dhe, në qoftë se i nxjerrim përpara të gjithë ushtrinë, në një ditë... në dy, në tri e shumta, do ta asgjësojnë tërësisht. Por, nëse e fenojmë me vijën e parë, e pengojmë me fortifikimet dhe pastaj shfrytëzojmë mbrojtjet natyrore, vargmalet, pyjet, nëse i shndërrojmë forcat tona në të pakapshme dhe të padukshme, mund të kemi shpresë të rezistojmë. Nuk i kam

kundërshtuar tezat e miratuara nga Këshilli i Mbrojtjes, por ato, siç e thotë dhe vetë fjala, ishin teza. Pra, duhet të provoheshin në praktikë dhe të integroheshin, të përshtateshin, të përmirësoheshin. E këtë bëra. Vetë Enveri më autorizoi t'i përmirësoja. Kam...

- Dhe e gjithë kjo nuk vlen për t'u mbrojtur në Byronë Politike?

I shoqi kaloi dorën në flokë, deri te qafa.

- Sipas tyre, unë doja ta fshihja ushtrinë, ta vija në tërheqje, në vend ta hidhja në betejë, doja t'ia lija vendin armikut.

- Por, çfarë argumentesh kanë për të të dëmtuar dhe akuzuar për këtë?

- Nuk munden të pranojnë ekzistencën e një armiku të aftë për të na asgjësuar... Kjo ide imja duhet të mbetet e fshehtë, për të duhet të kishim dijeni vetëm ne drejtuesit dhe komandantët e ushtrisë. Tërheqja dhe shpërndarja e forcave nuk duhet të ishin pjesë e strategjisë sonë zyrtare. Nuk do t'ua mësonim kadetëve të akademisë. Pa dyshim, do të stërvitnim njerëz për një mundësi të tillë, do të organizonim stërvitje, studime, por në shkollat ushtarake nuk do të përmendej kurrë. Dhe do ta përdornim vetëm në rast nevojë, si mundësi e fundit e shpëtimit përpara një sulmi të madh forcash sipërore ndaj tonave. Një zgjidhje të skajshme duhet ta kemi gjithnjë. Të gjithë e kanë dhe nuk vijnë të na e tregojnë. Kur nazistët sulmuan Bashkimin Sovjetik, Stalini i çmontoi të gjitha fabrikat dhe i dërgoi përtej Urave, në mbrojtje dhe atje riorganizoi ushtrinë. Pa dyshim, kjo nuk ishte e shkruar askund në tekstet e tyre të strategjisë ushtarake. Por, nuk ishte një lëvizje e sajuar aty për aty, nuk e shpik brenda një nate. Ishte zgjidhja e tyre ekstreme. Dhe ajo i shpëtoi. Në Itali thuhet se ekziston një lloj ushtrie klandestine, e panjohur, pa uniforma, e stërvitur dhe e gatshme të ribashkohet, nëse vendi pushtohet. Ne jo. Ne duhet të luftojmë në breg të detit deri tek ushtari i fundit, për të mos shkelur këmba e armikut në Shqipëri. Kjo i shkon propagandës, për të treguar dhëmbët, për ta bërë popullin luftarak, por ne drejtuesit, po të jemi të përgjegjshëm dhe nëse jemi pak të vetëdijshëm se çfarë është Shqipëria dhe cilët janë armiqtë tanë të mundshëm, ne, të paktën ne, nuk duhet të bëjmë propagandë, duhet të përgatisim plane emergjente për t'i realizuar nëse gjërat do të shkojnë vërtet keq. Por jo, ushtria jonë, ushtria e Shqipërisë socialiste nuk kthen shpinën, nuk ia dhuron tokën e saj armikut. Ushtria popullore nuk ka

frikë nga asnjë armik... E vërteta është se... - Këtu e ndërpreu fjalën, shtrëngoi buzët dhe vështroi në drejtim tjetër, pa folur më.

- Si është e vërteta?

- Këto teza, në vitin 1971, i ka menduar dhe i ka shkruar Mehmeti. Janë punë e tij. Kinezët na siguronin... kështu dukej asokohe... të gjithë avionët që donim, tanket, artilerinë, raketat, ne kërkonim e ata na i dërgonin... Dhe Mehmeti hartoi një plan mbrojtjeje të përshtatshëm për një fuqi përmasash mesatare, si të kishim popullsinë, forcat dhe territorin e Francës apo të Spanjës. Por, në Shqipëri ne jemi ata që jemi, e shumta ia dalim të kemi dy baza ajrore. Dy, - dhe zgjati dy gishta mes tij dhe së shoqes. - Një "Mig" yni, largësinë nga kufiri me Greqinë, nga Konispoli deri në Shkodër e bën për tetë minuta. Dhe nga Vlora deri në Korçë për më pak se tri. Në stërvitje, për të kryer një orë fluturim pilotët duhen të shkojnë lart e poshtë rreth shtatë herë. Për fat të mirë, janë ujërat ndërkombëtare. E njëjta gjë vlen për avionët gjuajtës armiq. Fluturojnë mbi Adriatik pa rënë në sy, pastaj papritmas kthehen dhe vijnë drejt nesh. Në një minutë a dy janë përsipër bazave tona. Në fakt, ne nuk kemi as kohën e mundshme për t'i parë në radar e të japim alarmin, sepse, ndërkohë ata lëshojnë bombat mbi pistat e Rinasit e të Qytetit Stalin. Dhe, po të na vijnë nga pas shpine, nga malet, nga Jugosllavia, e njëjta gjë është. Kjo është e vërteta. Vitin që shkoi, në Pekin, kur nxora listën e gjuajtësve që kërkonim, Çu En Lai filloi të qeshte dhe tha:

- E çfarë do të bëni me ta?

Në brendësi të vetes së tyre Enveri dhe Mehmeti nuk mund të mos e dinë se cilat janë mundësitë tona të vërteta të mbrojtjes. Por, nuk e shprehin. Enveri, sepse nuk i zë besë askujt prej nesh dhe sepse druhet të mbjellë shkurajim dhe pesimizëm mes drejtuesve, po të bëjë një arsyetim të tillë. Na konsideron të papjekur. Mehmeti nuk e thotë, sepse nuk e thotë Enveri. Hysniu nuk e...

- Po ti, përse e the? Ç'të shkrepni në kokë, ty?

Ai ngriti sytë dhe ndeshi në sytë e zemëruar të së shoqes, që e vështroi me ngulmim. Mori frymë thellë.

- Enveri më la të kuptoja se i quante ato teza një material teorik, mbi të cilin mund të punoja për përshtatje, modifikime... Duhet ta vija në provë me realitetin konkret të situatës sonë dhe të bëja ndryshimet e nevojshme, përmirësime...

- Përmirësime. Mirëpo, ti more vrull dhe fillove të thoshe atë që askush prej tyre nuk e kishte thënë kurrë.

- Por, bazuar në të gjitha fjalimet e Enverit mbi luftën partizane, mbi aktualitetin e Luftës Nacionalçlirimtare, mbi gueriljet në Vietnam, kurrë nuk kam menduar se jam jashtë vijës së Partisë. Përkundrazi, isha i sigurt se e kisha miratimin e tij. Enveri ishte aq i interesuar për metodat e gueriljes sa na tha të dërgonim një ushtarak në Vietnamin e Veriut, në xhungël, për të studiuar sistemet e luftimit të vietkongëve.

- Po atëherë, përse...?

- Problemi nuk është vija e Partisë dhe nuk është Enveri, - e ndërpreu ai. - Problemi im janë Mehmeti dhe Petriti. Ata, - dhe preu ajrin me dorë, si me drapër. - Është problem personal. Ideologjia dhe gjithçka tjetër nuk kanë fare lidhje, janë blloqe për të ngritur në këmbë këtë gjyq kundër meje.

- Po përse Mehmeti të ketë kaq mëri ndaj teje? Nuk i ka ardhur kurrë ndonjë e keqe prej nesh, gjithnjë i kemi treguar respekt të thellë, atij dhe Fiqretit. Kemi kaluar pushime bashkë, në Durrës... Fiqreti... Ishim vajza të vogla në Berat... Përse të të vihet kundër Mehmeti? Çfarë i ke bërë ti? Çfarë i kemi bërë?

- Nuk e di. Por, që nga tetori, kur Enveri pësoi infarkt, Mehmeti ka ndryshuar. Është nervoz, madje... është edhe më shumë se kaq. Është i padurueshëm. Çdo gjë e bezdis, çdo gjë, edhe një shaka, nëse dy shokë qeshin, nëse në Këshill dy ose tre ministra flasin me njëri-tjetrin. Ulërin, shfryn, na qorton sikur të jemi në shkollë. Gjithnjë arrogant ka qenë, por është përkeqësuar. Sillet kështu me të gjithë, nuk përjashton asnjë, me centralistët, me rojat, shoferët, me ne ministrat, pa asnjë dallim. Por, ndaj meje shpreh përbuzje. Më parë, kur ishim më të rinj, kishim një marrëdhënie të qetë. Por më pas, dalëngadalë, u largua. E kam vënë re me kohë se i shkaktoja bezdi. Kur ndodheshim të gjithë së bashku në Selinë e Partisë ose në ndonjë mbledhje dhe unë flisja, ose bëja shakara e shkaktoja të qeshura, ai nxihej në fytyrë. Të gjithë qeshnin, ndërsa ai shikonte për tokë ose gotën, me fytyrën e nderë, me një buzëqeshje false të ngrirë në buzë. A e di kur bëhej dhe më keq? Kur Enveri ia plaste gazit. Disa herë e bëja dhe me kast, për ta vënë në provë. Enverit i pëlqejnë disa proverba dhe mënyra të foluri të këtushme, të Tiranës, të zonës së Dajtit dhe kështu, kur krijohej atmosfera i tërhiqja vëmendjen

dhe thosha ndonjë proverb të lezetshëm. Enveri nganjëherë donte ta përsëritja dhe e mbante shënim. Nuk e merr dot me mend si ngrysej në fytyrë Mehmeti! Filloi të bënte sikur nuk më vinte re në takimet, nuk më afrohej kurrë ai vetë, përpiqej të më shmangej. Dhe në gostitë? Mua më pëlqen të bëj humor, të gjithë e dinë dhe shokët më ngacmonin të rrëfeja ndonjë barcaletë, ndonjë histori të këndshme dhe në fund vinin të gjithë rrotull meje dhe gjithnjë ma jepnin mua fjalën të thosha diçka për atë që ishte shkaku i festës e ta vija pak në lojë, sa për ta ndezur darkën. Për të kjo ishte vuajtje. Aq më tepër se shihje të qeshnin dhe shoqet. Më në fund, në shkurt, në urimin për ditëlindjen time nuk erdhi. I shkova në zyrë ta ftoja të pinte një gotë me ne, por m'u përgjigj se nuk kishte kohë për të humbur. "Jam shumë i zënë me punë, shumë." Qëndrova një çast aty dhe e vështrova, pastaj ika dhe mbylla derën pas vetes. Nuk më tha as "urime".

Në krye nuk e kuptoja. Mendoja se e tillë ishte natyra e tij, gjithnjë i ashpër, nervoz, i keq, dyshimtar për çdokënd, për të gjithë ne pa dallim. Por, jo. Nuk ishte vetëm kjo. Brenda tij i ishte ngjallur diçka e veçantë ndaj meje. Zilia për natyrën time të hareshme.

Më pas unë përpunova strategjinë e tërheqjes së forcave. Kjo ishte e tepërt. Dhe duhet të ketë vendosur me vete se kishte ardhur momenti të ma tregonte vendin. Ndoshta priste të bëja unë hapin e gabuar. Ia doli mbanë të më vinte të gjithë shokët kundër. Bindi Enverin dhe Hysniun se pas shpinës së Partisë po organizoja një punë të rrezikshme. Dhe ndërkohë, ndoshta edhe më parë, kishte filluar të më izolonte në ministri, duke ushqyer urrejtjen e Petritit. Debatet mes meje dhe Petritit kanë qenë të panumërta. Një njeri vërtet i padurueshëm për arrogancën që ka. Një i kompleksuar. Gjente të meta ngado, çdo gjë mund të bëhej më mirë, kritikonte gjithçka dhe nuk i mjaftonte vetëm për punën e vartësve të tij. Po në këtë mënyrë kritikonte edhe vendimet e mia. Ma bënte pas kurrit, por nuk ngurronte të më godiste edhe haptazi, në mbledhjet me ushtarakët, me mua aty të pranishëm. Mendjemadh. Pa kurrfarë respekti. Dhe përse guxonte dhe sillej kështu? - tha dhe i buzëqeshi së shoqes, duke hapur krahët. - Sepse e dinte që ishte i paprekshëm. Mund të hiqte këdo oficer, nga Shtabi i Përgjithshëm në Tiranë deri te posta e rojës më të fundit në kufirin me Jugosllavinë, mund të shkarkonte e të ndëshkonte këdo, por atij unë nuk i thosha dot asgjë,

as ta qortoja sadopak. Dhe unë jam ministri, kam gradën e gjeneralit, jam më i vjetër në shërbim e në moshë, jam anëtar i Byrosë Politike prej vitit 1948, ndërsa ai ka vetëm tre vjet. Jam zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave. Asgjë. Sepse, pas Petritit qëndron Mehmeti. Ja kështu. Dhe ai mburrej me të madhe që ishte mik i Mehmetit. Nuk harronte kurrë t'ua bënte të gjithëve të ditur se kishte qenë për darkë te Mehmeti, se kishte takuar Mehmetin dhe nëse aty isha e dëgjoja dhe unë, shtonte se kishte diskutuar me të çështje të ndryshme ushtarake, për këtë apo atë projekt mbrojtjeje. Petriti synon postin tim. E kam të qartë. Tani, këtë e dinë të gjithë në ministri. Duhet t'ia ketë premtuar vetë Mehmeti, prej kohësh. Por, Petriti nuk e njeh mirë Mehmetin. Dhe Mehmeti nuk e njeh Enverin...

- Mjaft! - e ndërpreu e shoqja. - Po ne? Si do të na vejë filli? Çfarë do të të bëjnë ty, djemve, mua? Ë? Unë e di mirë se si shkon kjo punë. Do të na shkatërrohet jeta. Do të na dëbojnë nga Tirana. Si mendon, do të na lënë të gjithëve bashkë apo do të na shpërndajnë andej këndeje? Do të na futin në burg, në një kamp pune? Çfarë do të ndodhë?

- Po, jeta nuk do të jetë më e njëjta. Do të na heqin të gjithëve prej këtu. Por, nuk e di se çfarë kanë vërtet ndër mend. - U përkul drejt saj dhe e vështroi thellë në sy. - Këtë jetë që kemi ta harrojmë. Universitetet, specializimet jashtë për fëmijët, vendet e punës, të gjitha. Për jetën tënde dhe të tyre mos ki frikë. - Zgjati krahun dhe deshi t'i kapte dorën. Por, mundi ta prekte vetëm fare pak.

- Po ty, çfarë do të të ndodhë? - pyeti gruaja. Tmerri e bënte të dukej vazhdimisht e zemëruar. Një vrundull ndjenjash të papërmbajtshme dhe të panjohura e përshkonin dhe e tronditnin, sa nuk kuptonte më thelbin e fjalëve dhe tonin me të cilin i shqiptonte, shqetësimin dhe vështirimin.

- Nuk e di. Mua mund të më ndodhë gjithçka, - u përgjigj i shoqi dhe uli zërin. - Mund të më nxjerrin në pension dhe të më internojnë bashkë me ju. Ose mund të më mbajnë në Tiranë, për të vazhduar gjyqin. Jam ministër i Mbrojtjes. Nuk kam organizuar festival kënge, prandaj për mua dënimi nuk mund të jetë si ai i Todit dhe i Fadilit. Do të më akuzojnë për disfatizëm, për mosbesim ndaj ushtrisë. Ndoshta... për tradhti, - dhe ngriti sytë e zhbiroi përsëri sytë e saj. - Një akuzë të rëndë, për dikë që ka detyrën time.

Heshti, i zhytur në kujtime e reflektime. Fjalë dhe qëndrime, heshtje dhe shenja miqësie, shkelje syri e ngërdheshje, prani dhe mungesë e shokëve të tij bashkëpunëtorë. Për herë të parë iu duk se kishin një logjikë, një arsye. Sikur gjithçka e padukshme, që e kishte rrethuar deri tani në ministri, në Byronë Politike, në Komitetin Qendror, në tribunën e paradave ose në Këshillin e Ministrave, sikur çdo gjë e mbetur e pazbërthyeshme për vite, më në fund ishte deshifruar dhe po shpallte një fund të qartë.

E shoqja e kuptoi se çfarë deshi të thoshte. Hoqi sytë prej tij. Në çast e përfytyroi veten të vetme, në ndonjë fshat të panjohur, fundja të gjithë njësoj ishin, me shtëpitë e pasuvatuara e me rrugën përpara plot pëllgje. Ndjeu se mund t'i bënte ballë. Duhet t'i bënte ballë, sepse të gjithë kishin ende nevojë për të. "Sikur të paktën të na lënë të gjithëve bashkë."

Përmes të çarave të vogla të grilave gjysmë të ngritura, shqoi dritën e ditës, që tani ishte mjaft e qartë. Ndoshta ora kishte vajtur gjashtë. Takimi në Byronë Politike ishte më dhjetë. Sikur të mundte ta bindte të pushonte një orë...

U ngrit e i shkoi pranë. Ai dukej i përhumbur dhe ajo u përkul mbi të e i fërkoj faqen dhe, pa e kuptuar u gjend e shtrënguar në krahët e tij. Ai e tërhoqi pas vetes dhe i futi kokën në prehër. Gjithnjë merrte forcë prej saj dhe ajo prej tij, po ashtu. Përqaftimet e tyre të forta, të gjata, të fshehta, u kishin ushqyer jetën dhe dashurinë. Kështu ndodhi dhe atë mëngjes.

Më nëntë, një orë përpara, ministri doli dhe përshkoi ato pak qindra metra që e ndanin nga shtëpia e deri te Komiteti Qendror. Edhe policët u habitën, kur e panë të dilte. Ecte me hapin e tij të zakonshëm e me lëkundje dhe me çantën e lëkurës nën krah. Dukej si një mëngjes i ngjashëm me shumë të tjerë, sikur të mos mungonin ushtarët dhe të mos ishin shtuar policët e veshur civilë. I ndiente vështirimet e tyre mbi vete. Mbështetur pas murit të ulët pak më tej gardhit të vilës, njohu shefin e drejtorisë së operacioneve speciale të Ministrisë së Brendshme. Edhe prania e tij mund ta bënte atë ditë të dukej e ngjashme me të tjerat. Idrizi vërtitej gjithnjë në *Bllok* dhe kur shihte të shfaqeshin udhëheqësit

e Partisë këqyrte përreth për shkak të deformimit profesional të një jete të kaluar me dyshime dhe pastaj vinte grushtin e majtë anash ballit. Ndryshe nga herët e tjera, atë mëngjes, Idrizi nuk u shkëput nga muri, nuk shikoi majtas e djathtas, por ia nguli sytë ministrit. Ministri ngriti të tijtë dhe Idrizi, ndonëse dinte gjithçka, për inerci të respektit e gati-gati me hutim ngriti ngurrues krahun, e ndali, e lëvizi përsëri lart, derisa grushti iu zhduk në xhep, pa e arritur tëmthin.

Ministri ktheu sytë dhe shikoi asfaltin. Ishte gjithë pluhur. Atë natë nuk kishin lënë as autobotin të kalonte. Mendoj për herë të fundit për autokritikën dhe për herë të fundit vrau mendjen nëse ai ishte vendimi i duhur.

Kam vetëm një mundësi të shpëtoj familjen. Duhet të pranoj gjithçka, duhet të njoh gabimet, shmangien nga vija, rrezikun për atdheun dhe Partinë. Jam treguar sipërfaqësor, arrogant, mendjemadh, mikroborgjez, arrivist. Gjithçka. Duhet të marr përsipër çdo faj, të pranoj se kam gabuar. Kam nevojë të riedukohem. Do të punoj me veten. Do të zhduk prirjet mikroborgjeze dhe liberale që më kanë hedhur rrënjë në kokë. Nuk e kisha kuptuar të keqen që po i bëja Shqipërisë socialiste. Nuk duhet t'i nxe.

Zbriti trotuarin, përshkoi rrugën e u hodh djathtas. Nga pas ndjeu se në njëfarë largësie po e ndiqnin pesë a gjashtë veta.

Mendoj edhe një kundërprovë të fundit. *Do të mbrohem në çdo goditje, duke këmbëngulur se kam bërë gjënë e duhur, forca kundërshtare në betejë, njerëz, fuqi zjarri, përparim teknologjik; forcat tona, njerëz, fuqi zjarri, viti i fabrikimit të tankeve dhe të avionëve luftarakë, gjendja në magazinë e pjesëve të këmbimit, shtrirje territoriale. Ndodh përplasje mes meje dhe Mehmetit. Luftë. I bëj qëndresë. Dhe patjetër që e dërmoj. Gjendja është e qartë dhe banale. Nuk ka nevojë për analiza ose studime të thella strategjike. Ai nxjerr tezat, tekstet sovjetike të strategjisë, mbrojtjen e çdo centimetri toke shqiptare. Shifra dhe periudha kohore me reagim të menjëhershëm, i dëshmoj se e tija është thjesht propagandë dhe në rast sulmi do të jetë e vetmja mënyrë për të shpëtuar ushtrinë dhe për të ruajtur një shpresë për Shqipërinë: t'u ngjitemi maleve. Çfarë bën Enveri? Kë do të zgjedhë? Ka vetëm një mundësi: ose mua, ose Mehmetin. A e lejon dot humbjen e Mehmetit? E pamundur. E pamundur! Dënimi im është i sigurt. Nuk ka rrugëdalje.*

Sigurisht, do ta thosha timen deri në fund, mund të them gjithë sa mendoj, i humbur se i humbur jam. Por, kështu do t'i tërboj e do të bëhen si kafshë të etura për gjak. Siç ndodh dhe me qentë e egër: po i pe në sy çmenden fare dhe të hidhen në fyt. Furia e tyre nuk do të qetësohet vetëm me mua. Zemërimi i verbër do të shpërthejë ndaj të gjithë familjes.

Kur arriti në fund të rrugës u hodh përsëri majtas dhe përshkoi metrat e fundit.

Po të isha i vetëm në këtë botë, do të mbrohesha me nder deri në fund. Por, më duhet të ul kokën. Duhet t'i zbus. Duhet të pranoj të gjitha akuzat dhe t'ua ftoj zemërimin. Nuk duhet t'i vështroj në sy.

Qielli ishte i kthjellët, dielli tashmë i ngrohtë hidhte dritë të fortë përmbi drurët e parkut. Ministri mbushi mushkëritë me ajër dhe thithi aromën e jaseminëve dhe të blirëve. Llogariti me mendje sa ditë kishte qëndruar i mbyllur në shtëpi; gjashtëmbëdhjetë. Por, akoma nuk i kishte humbur të gjitha, prej këtij çasti detyra e tij ishte të shpëtonte çfarë kishte më të çmuar. U kthye në të majtë, ngjiti shkallët e ndërtesës dhe shtyu fort derën e rëndë.